



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në subjektin Bashkia Cërrik

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

BASHKIA CËRRIK

Tiranë 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			2-2
I		PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-8
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.		HYRJA	8-13
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	9
	2	Identifikimi i çështjes	9
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
	4	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
	5	Kriteret e vlerësimit	11-12
	6	Standardet e auditimit	12
	7	Metodat e auditimit	12-13
	8	Dokumentimi i auditimit	13
III.		PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13-14
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit	
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	14-19
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	20-21
	2.2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	21-33
	2.2.6	Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre	33-43
	2.3	Vlerësimi Raportimit Financiar	43-60
	2.4	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	61-88
IV.		GJETJET DHE REKOMANDIMET	88-97

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Cërrik është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Cërrik (qyteti), Njësitë Administrative Mollas, Gostimë, Shalës dhe Klos.

Buxheti i Bashkisë Cërrik si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Cërrik si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Cërrik. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- Mbi burimin dhe krijimin e të ardhurave.
- Mbi vlerësimin e raportimit financiar.
- Mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. **Vlerësimi i riskut të kontrollit;**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2024 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 10,148 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 1,015 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli); Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodot dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime, nga ku masa organizative me 13 gjetje dhe 15 rekomandime, 2 gjetje-rekomandim si efekt negativ në administrimin e fondeve publike dhe 3 gjetje-rekomandime në fushën e të ardhurave.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ **Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit:**

-Për vitin 2024, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifikën ka vlerën 504,005 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 573,872 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 507,376 mijë lekë ose në masën 88 %.

Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 238,772 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 232,876 mijë lekë ose në masën 97%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 123,468 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 123,206 mijë lekë ose në masën 99%.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 22,362 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 14,768 mijë lekë ose në masën 66 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230*231) është planifikuar në vlerën 145,819 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 136,526 mijë lekë ose në masën 93%.

-Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

Kryetari i Bashkisë nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak *“Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”*.

Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme është paraqitur në Këshillin Bashkiak dhe është miratuar me VKB nr.29, datë 27.04.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.527/1 prot, datë 03.05.2023. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *“ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”*.

Tavanet Buxhetore për PBA 2024-2026 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.29, datë 27.04.2023 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *“ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”*.

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave:**

- Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën 172,883 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 139,607 mijë lekë ose në masën 80,75 % me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 37,117 mijë lekë.

- Nga auditimi i të ardhurave të vitit 2024 u konstatua se nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve.

- Nga auditimi i kontrata të qirasë rezulton se Bashkia Cërrik ka lidhur gjithsej 700 kontrata qiraje të cilat i përkasin Bashkisë Cërrik dhe Njësive Administrative (ish-komunat). Njësia Administrative Mollas disponon 62% të totalit të kontratave ose 431 kontrata, këto kontrata janë lidhur përpara vitit 2015 nga ish Komuna Mollas.

Nga këto kontrata 273 janë aktive të cilat ju ngarkohet detyrimi referuar kontratës dhe paguajnë rregullisht. Për 158 kontrata nuk janë ngarkuar detyrimet prej vitit 2017 për shkak sepse është paraqitur kërkesës nga abonentë për zgjidhjen e kontratës por nuk është konkluduar më tej.

Nga këto 92 kontrata janë me vlerë detyrimi në shumën 14,323,599 lekë ndërsa 66 kontrata nuk kanë vlerë detyrimi.

- Nga auditimi konstatohet se detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2024, janë në vlerën **60,988 mijë lekë**.

Detyrime abonentët familjarë në vlerën **43,918 mijë lekë** e cila përbëhet nga 3,820 abonentë familjarë;

Detyrime nga bizneset në vlerën **17,070 mijë lekë** e cila përbëhet nga 86 subjekte biznesi;

Nga auditimi konstatohet se gjendja debitore nga taksa e infrastrukturës më datë 31.12.2024, është në vlerën **20,682,982 lekë për 497 persona** shumë e cila është e ardhur e pa arkëtuar për Bashkinë Cërrik.

- Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 11 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Cërrik të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë.

Nga auditimi i pagesave për licencat e subjekteve të hidrokarbureve, rezultoi se 6 subjekte kanë kryer total pagesën në vlerën 1,000,000 lekë ndërsa 5 subjekte në kundërshtim me VKM Nr. 344 kanë kryer pagesa pjesore nga 200,000 lekë çdo vit.

▪ **Vlerësim i raportimit financiar:**

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” është paraqitur në bilanc në vlerën 43,500,252 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2024 dhe është regjistruar në bilanc në vlerën 43,500,252 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar në mënyrë analitike, por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite.

- Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është paraqitur në bilanc në vlerën 11,169,913 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 600,000 lekë projekt i transferuar nga llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 11,769,913 lekë.

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar në mënyrë analitike, por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite.

- Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2024 nuk disponon një regjistër të përditësuar në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe 27.

-Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” gjatë vitit 2024 u verifikuan shtesa për 2 investime në shumën 39,521,259 lekë.

1- Përmirësim i banesave sociale 11,934,793 lekë

2- Përmirësim i banesave sociale 27,586,466 lekë

Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 “ Ndërtesa dhe Konstruksione” nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Cërrrik. Këto janë asete në pronësi të komunitetit të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ Bashkia Cërrrik ***në lidhje me të ardhurat***, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 60,988 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 497 debitorë në vlerën 20,682 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Cërrrik të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Cërrrik, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,800,000 lekë për subjektet.

-“G” sh.p.k. Gostim me NIPT L5 detyrimi 200,000 lekë

-“G” sh.p.k. Kamuna me NIPT L5 detyrimi 600,000 lekë

- “D”sh.p.k me NIPT L4 detyrimi 400,000 lekë

- “X”sh.p.k. me NIPT L4 detyrimi 200,000 lekë

- “L”sh.p.k me NIPT L5 detyrimi 400,000 lekë

▪ Bashkia Cërrrik në lidhje ***me planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit*** të marrin masat e nevojshme, për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

▪ Bashkia Cërrrik ***në lidhje me vlerësimin financiar***, të marrin masat të kontabilizoj saktë llogaritë kontabël 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar”, 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, dhe 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, 202 “Studime dhe Kërkime”, 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Plantacione”, 212 ‘Ndërtesa’ dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2024:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Cërrik për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2024 - 31.12.2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinionin:

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin e kualifikuar” pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë Cërrik më 31 dhjetor 2024, referuar udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Cërrik. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2024, paraqiten si më poshtë: Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 78,960,587 lekë.

-Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 142,766,033 lekë.

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 39,521,259 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 408/1, datë 08.04.2024, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.04.2025 deri në datë

09.06.2025, në subjektin Bashkia Cërrik për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.H, *Përgjegjës grupi*,
2. A.V, auditues;
3. M.M, auditues;
4. G.K, auditues;
5. E.G, auditues;
6. B. B, auditues;

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Cërrik.

2. Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Cërrik, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Cërrik.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Cërrik (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Cërrik, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Cërrik dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Cërrik është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 4, datë 26.01.2024 “*Për miratimin e manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së*

Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë së Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimin të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*” .

- *Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore*: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”*” i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”; i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
 - *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 5 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikimi. Gjatë hartimit të raportit të auditimit, sipas përcaktimeve ligjore nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti Bashkia Cërrik.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Cërrik u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Bashkia Cërrik kufizohet në veri me bashkitë Elbasan dhe Peqin, në jug-lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Cërrikut. Bashkia Cërrik përbëhet nga 5 Njësi Administrative që janë, Cërrik, Shalës, Mollas, Gostimë dhe Klos.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2024, Bashkia Cërrik numëron 25,163 banorë. Bashkia e Cerrik ka një sipërfaqe prej 189.65 km².

Historik i zhvillimit ekonomik: Bashkia e Cërrikut shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore në përgjithësi mes dy lumenjve, Shkumbin dhe Devoll dhe ka si qendër qytetin e Cërrikut, një ish qytezë industriale, i shpallur si qytet më 1952 me ndërtimin e Uzinës së Përpunimit të Naftës dhe një Termocentrali, të cilat iu shtuan qendrës së shërbimeve për bujqësinë.

Sfidat me të cilat përballlet: Bashkia përballlet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit historik dhe kulturor përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike; Krijimi i mundësisë së integritimit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si ekoturizmi dhe turizmi i aventurës; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Cërrik si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. **Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:**

Në lidhje me parimin 1 :“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

-Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

-Bashkia Cërrrik përgjatë për vitin 2024, ka vepruar në zbatim të Rregullores së Brendshme të për organizimin dhe funksionimin e institucionit të bashkisë.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Cërrrik nuk ka miratuar Kodin Etik.

-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3,1.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë, z. A.S.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë Cërrrik, ato regjistrohen pranë Zyrës së Koordinatorit të së drejtës së informimit dhe të drejtës me publikun me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

-Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

Në lidhje me parimin nr 2: “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Për vitin 2024 nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk rezultojnë të jenë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Nga njësitë e varësisë ka raporte 6 mujore për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Nga auditimi rezulton se lidhur me strukturën organizative, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Cërrik ka miratuar strukturën organizative për vitin 2024 me VKB nr.80, datë 24.11.2023. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën me nr 2573/2 prot më datë 21.12.2023.

-Bashkia Cërrik ka gjithsej 289 punonjës.

-Për vitin 2024 janë kryer vlerësimet periodike për punonjësit me status nëpunësi civil.

-Për vitin 2024 janë rekrutuar dhe larguar nga puna punonjësit si më poshtë.

Tabela nr.1: Lista me emrat e punonjësve të punësuar gjatë vitit 2024

Nr	Emër Mbiemër	Profesioni
1	E.B	Sanitare
2	V.T	Ndihmës zjarrëfikës
3	B.S	Specialiste mjedisi
4	E.Z	Ndihmës mësuese
5	K.B	
6	K.S	Ndihmës mësuese
7	L.B	Sanitare
8	S.M	Mësuese
9	A.A	Punonjës Kadastre
10	G.C	Punonjës gjelbërimi
11	A.B	Punonjës mirëmbajtje
12	O.B	Specialiste
13	A.Gj	Agjent terreni pjese e grupit te punes se vjeljes se detyrimeve ne tregjet Cerrrik, Gostime, Mellas
14	S.Sh	Punonjes sektori I koordini mit te sherbimeve
15	Xh.C	Specialist I Emergjencave Civile
16	A.S	Sanitare Shkolla Shushice
17	A.B	Sanitare Shkolla 7 marsi Ferme
18	G.G	Shofer
19	M.C	Këshilltari i Kryetarit të Bashkisë
20	R.A	Punonjes Mirembajtje

Burimi: Bashkia Cërrik

Tabela nr.2: Lista me emrat e punonjësve të larguar gjatë vitit 2024

Nr	Emër Mbiemër
1	Q.M
2	E.LL
3	A.B
4	L.X
5	I.B
6	L.B
7	L.S
8	I.A
9	E.Xh
10	R.J

Burimi: Bashkia Cërrik

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Cërrik nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit, për vitin 2024 në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1. Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. H. K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Burimeve Njerëzore.

-Për Bashkinë Cërrrik Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, z. A. S.
-Për vitin 2024, detyra e nëpunësit zbatues është mbuluar nga Drejtori i Financave, z. H.K. ,z. K ka arsimimin e duhur për ushtrimin e kësaj detyre në përputhje me përcaktimet e ligjit.
-Me Urdhërin nr. 4 datë 14.02.2024, Kryetari i Bashkisë Cërrrik ka caktuar si Koordinator Risku, znj. M. Xh, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrrik.
-*Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*
Me shkresën me nr. 42 prot, datë 19.02.2024, Kryetari i Bashkisë Cërrrik ka ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik me përbërje: znj. M. Xh, z. H. K, znj A. B., znj. E. C., z. F.U., z. Ç.Sh., z. E.T., z. F. A., znj. I. Ç., z. K. B., znj. E. D.. Nuk dokumentohet realizimi i takimeve të GMS përgjatë vitit 2024, mosveprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualin për MFK” ku citohet se “*Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe nëpërputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë*”, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16 të MFE, pika 2.2.4, “Manuali MFK” Kreu II kap. 2.2.6. Për sa më sipër mban përgjegjësi sekretari i Grupit të Menaxhimit Strategjik, z. H. K.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Nuk është miratuar një regjistër i integruar i riskur për të gjithë institucionin.

-*Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12, pika d.*

-Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtori i Financë dhe Burimeve Njerëzore, z. H. K

-Nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut.

-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8, pika 8, gërma a.

- Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. A.S, me detyrë Kryetar i Bashkisë.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Në Bashkinë Cërrrik Drejtorja e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

-Nga auditimi rezulton se, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Cërrrik, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e 122.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryetar i Bashkisë Cërrrik, z. A. S.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Me Urdhërin nr.04 datë 09.01.2024 “Për ngritjen e njësisve përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashkinë Cërrrik, Kryetari i Bashkisë Cërrrik ka ngritur Njësinë e Sinjalizimit të Bashkisë Cërrrik me përbërje: znj. D. M me detyrë specialiste e Njesisë së Auditit të Brendshëm, z. Xh. S me detyrë specialist jurist, S. Sh me detyrë specialist i IT-së. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të vënë në dispozicion, u konstatua se nuk është miratuar Rregullorja për Mekanizmat e Hetimit Administrativ dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga Hakmarrja.

-Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 13, pika 10 të Ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Cërrik, z. A.S.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Cërrik ka hartuar Planin për Kontrollin e Brendshëm dhe Regjistrin e Riskut për vitin 2024 në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Bashkia Cërrik ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve të punës.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për të janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Cërrik.

-Bashkia Cërrik në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Cërrik, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Bashkia Cërrik ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë <https://www.bashkiacerrik.gov.al/> Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda

institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

-Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

-Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

-Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen e objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Bashkia Cërrrik lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2024 me shkresën me nr. 42, prot, datë 28.02.2025. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet problematikat në 5 komponentët e MFK. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

z. A.S me detyrë Kryetar i Bashkisë Cërrrik

z. H. K. me detyrë Drejtor i Financës dhe Burimeve Njerëzore.

2.1.2 Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm;

Në Bashkinë Cërrrik në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2024, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr.80, datë 24.11.2023, duke pasur në strukturën e saj tre punonjës. Përgjegjësi i kësaj njësie është znj. D. M.

Tabela Nr.3: Struktura e njësisë AB për vitin 2024

Nr	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
1	D.M	Specialist	i lartë	38	8	Certifikuar	40 Ore
2	S.Xh	Specialist	i lartë	4	1	I pa certifikuar	

Burimi:Bashkia Cërrrik

Për vitin 2024, Njësia e Auditit të Brendshëm ka në përbërje dy specialistë të Auditit të Brendshëm, në vend të tre punonjësve që përcakton VKM nr. 83 datë 03.02.2016, pika 3. Drejtorja e Burimeve Njerëzore duhet të kishte marrë masat për plotësimin e vakancës në Sektorin e Auditit të Brendshëm, për mirëfunksionim e kësaj njësie.

-Për vitin 2024 niveli profesional i punonjësve në Sektorin e Auditit të Brendshëm nuk është sipas përcaktimeve të bëra në nenin 11 pika ç të Ligjit nr. 114 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Sipas këtyre dispozitave numri i punonjësve të pa certifikuar si “Auditues i Brendshëm” nga autoritetet përkatëse, nuk mund të kalojë 1/3 e numrit total të punonjësve në Njësinë e Auditimit, ndërkohë që z. S. Xh. nuk është pajisur me certifikatën e Audituesit të Brendshëm.

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore duhet të kishte marrë masat për plotësimin e strukturës së auditit të brendshëm me punonjës të pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi z. H. K., me detyrë Drejtor i Financës dhe Burimeve Njerëzore.

2.1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm

-Nga auditimi i dokumentacionit fizik dhe elektronik të vënë në dispozicion, konkretisht Plani i Punës miratuar me shkresën me nr. 2270 prot. datë 29.10.2023, u konstatua se nga NJAB ishte planifikuar të kryheshin: 1 auditim financiar, 1 auditim i kombinuar, 1 audit performance dhe 3 auditime përputhshmërie si dhe 1 auditim tematik mbi zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023. Auditime do të kryheshin konkretisht mbi këto njësi: Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Planifikimit të Projekteve, Drejtorja e Taksave (Detyrimet e Prapambetura). Njësia Administrative Gostimë, Njësia Administratitve Shalës, Drejtorja Juridike/Sektori i Prokurimeve.

Tabela 4 :Realizimi e auditimeve për vitin 2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
	Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				Tjera
			Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	
Viti 2024	7	6	4	-	2		-

Burimi:Bashkia Cërrrik

-Për sa më sipër konstatohet shmangie nga Plani Vjetor i Auditimit, e cila nuk është argumentuar në Raportin Vjetor dërguar MFE/Njësisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm shkresën me nr. 319/1 prot, datë 05.02.2025.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Manualin për Auditimin e Brendshëm “Formatet Standard për Kapitullin IV”.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi, znj. D. M., me detyrë specialiste e auditit të brendshëm

-Plani strategjik 2024-2026 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.2271 prot. datë 19.10.2024.

-Plani vjetor për vitin 2024, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm , me shkresën nr. 2270/1 datë 19.10.2024.

-Për aktivitetin e vitit 2024 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 917/1 prot. datë 05.02.2025.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është miratuar Karta e Auditit të Brendshëm.

-Për vitin 2024 nga auditimet janë evidentuar 36 gjetje, për të cilat janë dhënë 38 rekomandime.

Në **aneksi nr. 2/1/1 në anekset** e raportit të auditimit është paraqitur tabela e cila pasqyron llojet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2024.

Në **aneksi nr. 2/1/2 në anekset** e raportit të auditimit është paraqitur tabela e cila pasqyron gjetjet e evidentuara nga auditimet e kryera gjatë vitit 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2024, ka qenë përgjithësisht në përputhje me urdhërin nr, 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 neni 22 dhe neni 19 pika 1 e Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreun 6 të Manualit të Brendshëm të Auditimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi specialisti i auditit të brendshëm, znj. D. M.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi

Kryetari i Bashkisë Çërrik, z. A.S., specialisti i NJAB, znj. D. M., Drejtori i Financës dhe Burimeve Njerëzore, z. H. K.

2.2. Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultojnë se:

-Kryetari i Bashkisë nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak **“Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”** për miratim në kundërshtim me Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 **“ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”**

-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS)** për PBA 2024-2026 me Urdhrin nr. 3 datë 10/01/2023.

-**Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme** është paraqitur në Këshillin Bashkiak dhe është miratuar me VKB nr.29, datë 27.04.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr.527/1 prot, datë 03.05.2023. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 “ *Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2024-2026 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.29, datë 27.04.2023 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 “ *Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

Referuar pikës nr. 64 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*”. Kryetari i Njesisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavanëve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2024-2026 janë miratuar me VKB nr. 56, datë 31/07/2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 897/1 prot., datë 07/08/2023 në kundërshtim me ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” dhe udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*” pika 79 “*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim, brenda datës 15 korrik, tavanet përfundimtare në Këshillin e Njësive Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik*”.

- **Faza e dytë e PBA 2024-2026**

Me VKB nr.68 ,datë 29.09.2023 është miratuar kalendari i konsultimeve publike për buxhetin 2024 dhe PBA 2024-2026. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.1087/1, datë 09.10.2023.

Kalendari i Konsultimeve publike është miratuar në kundërshtim me udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*” pika 82 “ *Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator. Procesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, behën pjesë e dokumentit të projektit të PBA*”.

Pika 84 “*Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë*”.

PBA 2024-2026 dhe buxheti i vitit 2024 për Bashkinë Cërrrik janë miratuar me VKB nr.87, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 07/1, datë 15.01.2024. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Tabela Nr.5: Programimi i shpenzimeve për vitin 2024-2026 Bashkia Cërrrik dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	%	000/lekë	%	000/lekë	%
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)	66,630	13.2%	67,130	12.8%	69,013	12.5%
2	Shërbimet e Policisë Vendore (031140)	6,470	1.3%	6,700	1.3%	6,800	1.2%
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	17,432	3.5%	18,432	3.5%	19,700	3.6%
4	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve (04220)	6,080	1.2%	7,410	1.4%	7,910	1.4%
5	Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)	32,084	6.4%	29,636	5.6%	34,442	6.3%
6	Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave	4,035	0.8%	4,620	0.9%	4,85	0.9%
7	Rrjeti rrugor rural (04520)	99,588	19.8%	113,838	21.7%	116,592	21.2%
8	Menaxhimi i mbetjeve (05100)	52,335	10.4%	52,400	10%	52,400	9.5%
9	Planifikimi urban vendor (06140)	20,551	4.1%	18,745	3.6%	23,554	4.3%
10	Shërbimet Publike vendore (06260)	54,420	10.8%	54,997	10.5%	57,615	10.5%
11	Sport dhe Argëtim (08130)	18,200	3.6%	19,200	3.7%	14,100	2.6%
12	Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat (08220)	6,748	1.3%	8,350	1.6%	6,770	1.2%
13	Arsimi parashkollor përfshirë dhe arsimin bazë (0910)	79,697	15.8%	82,581	15.7%	94,720	17.2%
14	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)	8,787	1.7%	9,300	1.8%	9,400	1.7%
15	Përkujdesje Sociale fëmijët (10430)	14,390	2.9%	14,900	2.8%	14,950	2.7%
16	Fonde Rezervë	3,000	0.6%	3,000	0.6%	3,000	0.5%
17	Fond Emergjence	8,632	1.7%	8,870	1.7%	9,600	1.7%
	Total	504,006	%	55,351	100%	550,775	100%

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela Nr.6: Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2024-2026 Bashkia Cërrik, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	184,062	36.5%	188,082	35.8%	193,220	35.1%
2	Sigurime. (601)	32,314	6.4%	33,202	6.3%	35,051	6.4%
3	Shpenzime operative (602)	121,444	24.1%	17,820	24.3%	131,313	23.8%
4	Shpenzime (604)	1,500	0.3%	1,500	0.3%	1,500	0.3%
5	Shpenzime (606)	12,473	2.5%	13,320	2.5%	14,500	2.6%
6	Fondi rezerv dhe kontigjencës 609	3,000	0.6%	3,000	0.6%	3,000	0.5%
7	Investime (230)	10,000	2%	9,296	1.8%	7,706	1.4%
8	Investime (231)	139,212	27.6%	149,131	28.4%	164,935	29.9%
	Total	504,005	100%	525,351	100%	550,775	100%

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela Nr.7: Sipas PBA 2024-2026 Bashkia Cërrik tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2024-2026.

A	Të ardhurat	2024	%	2025	%	2026	%
1	Nga taksat	66,410	38.41	70,437	38.6	71,440	38.7
2	Jo tatimore	106,473	61.59	112,137	61.4	113,325	61.3
I	Totali	172,883	34.30	182,574	34.8	184,765	33.5
1	Transferta e pakushtëzuar	213,625	64.52	221,743	64.7	239,810	65.5
2	Transferta specifike	117,498	35.48	121,034	35.3	126,200	34.5
II	Shuma e transfertave	331,123	65.7	342,777	65.2	366,010	66.5
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)	0	0	0	0	0	0
	Totali I burimeve të veta (I +II+III)	504,006	100	525,351	100	550,775	100

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor

Për vitin 2024, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 87, datë 27.12.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 07/1 date 15.01.2024.

Sipas VKB nr. 87 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2024 ” rezulton se të ardhurat nga burimet e vete të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën **172,883 mijë lekë**, transferata e pakushtëzuar ka vlerën **213,625 mijë lekë**, transferata specifike ka vlerën **117,497 mijë lekë**.

I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2024 paraqitet në vijim:

Tabela Nr.8: Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2024	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor 2024	172,883	
3	Të ardhura nga Transferata e Pakushtëzuar	213,625	
4	Të ardhura nga Transferata e Pakushtëzuar Sektoriale	117,497	
5	Paga (600)		184,062
6	Sigurime shoqërore (601)		32,314
7	Shpenzime operative (602)		121,444
7	Transferata KQ 604		1,500
8	Transferata individë, familje në nevojë (606)		3,841
9	Fonde emergjencia		8,632
10	Fondi Rezervë dhe kontigjences (609)		3,000
11	Projekte (230)		10,000
12	Investime (231)		139,212
Totali i buxhetit		504,005	504,005

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **504,005 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2024 është bërë si vijon:

Gjatë vitit 2024 sipas VKB Nr.87, datë 27.12.2023 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 149,212 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferata e pakushtëzuar.

-Likuidime për investime të përfunduara për të cilat janë akumuluar detyrime të prapambetura është parashikuar të likuidohet shuma 50,365 mijë lekë. Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2024 janë në vlerën 98,847 mijë lekë.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyt e këtyre ndryshimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Cërrik dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme,

janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Gjatë vitit 2024 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten Në **aneksi nr. 2/2/1 në anekset** e raportit të auditimit.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga Sektori i Buxhetit dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë .

Tabela nr. 9 :Paraqiten plani përfundimtar për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024.

Nr	Pershkrimi	Ardhurat 2024	Shpenzimet 2024
1	Të ardhura të trashëguara viti 2023/2024	12,567,683	
2	Plani i të ardhurave viti 2024	172,883,000	
3	Trashëguar nga transfertat viti 2023	15,745,311	
4	Transfertë e pakushtëzuar viti 2024	238,454,249	
5	Transfertë e specifike viti 2024	124,314,651	
6	Te trashëguara nga kap.6	9,907,268	
	Shpenzimet		
1	Paga (600)		198,262,000
2	Sigurime shoqërore (601)		34,889,428
3	Shpenzime operative (602)		127,978,963
4	Trasferta te KQ		3,534,798
5	Transferta te individe familje ne nevoj 606		8,349,055
6	Fonde rezerve dhe Emergjencia		8,632,000
7	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		192,225,920
Totali		573,872,163	573,872,164

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Në **aneksi nr. 2/2/2 në anekset** e raportit të auditimit paraqiten të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit sipas burimeve të të ardhurave dhe ndryshimet për vitin 2024 sipas VKB përkatës.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Elbasan si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Elbasan, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Elbasan, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Në **aneksi nr. 2/2/3 në anekset** e raportit të auditimit paraqitet të dhënat realizimi i treguesve të buxhetit në nivel bashkie, referuar akt-rakordimet me thesarin.

Tabela nr. 10: Realizimi i buxhetit në drejtim të shpenzimeve në mënyrë të përmblodhur për aparatin e bashkisë dhe institucionet e varësisë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2024	Plani përfundimtar 2024	Plani i çelur 2024	Realizimi i shpenzimeve 2024	% e realizimit/
					planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	184,062	203,112	203,990	203,112	99.6
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	32,314	35,660	35,660	35,385	99.2
Shpenzime operative (602)	121,444	129,777	129,771	129,494	99.8
Subvencione (603)	-	-	-	-	-
Transferta tek organizatat (604)	1,500	7,884	7,440	5,439	73.1
Transferta tek individët (606)	3,841	397,812	397,230	394,694	99.4
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	3,000	-	-	-	-
Fondi e Emergjencës	8,632	8,632	7,000	-	-
Shpenzime për Oponenca teknike (230)	10,000	10,000	8,194	5,935	72.4
Shpenzime per Investime (231)	139,212	318,179	273,578	220,819	80.7
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtez	139,212	139,212	137,625	130,591	94.9
b.Nga Ministrite linjes	0	178,967	135,953	90,228	66.4
Total	504,005	1,111,057	1,062,863	994,878	93.6
a.Nga te ardhurat e transf e pakushtëzuar	504,005	573,871	525,678	513,587	97.7
b.Nga Ministrite linjës	0	537,185	537,185	487,502	90.8
Total Bashki + Institucione	504,005	1,111,056	1,062,863	994,878	93.6

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

Për **vitin 2024** fondet buxhetore janë realizuar 994,878 mijë lekë nga 1,062,863 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 93.6 %. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:

a. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi i fondeve në zërat, llog.602 “Shpenzime operative” në masën 99.8%, llog.604 “Transferta tek organizatat” në masën 73.1%, llog.606 “transfertat tek individët (nd.ek e invalid)” në masën 99.4%, “Fondi i Emergjencës” në masën 0 %,

b. Shpenzimet për investime llog. 230-231 nga buxheti i Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar janë realizuar ne masen 80.47 %, ku llog.230 “Shpenzime për oponencë teknike” në masën 72.8% dhe llog.231 “Shpenzime për investime” në masën 80.7 %.

-Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Për vitin 2024 janë planifikuar fonde për investime në shumën **281,772 lekë** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura + transfertë e kushtëzuar) dhe janë **realizuar në vlerën 226,754 lekë, ose në masën 80.47%**.

• **Fondet për investime nga të ardhurat e Bashkisë**

Për **vitin 2024** janë planifikuar në vlerën 144,819 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 136,525 mijë lekë ose realizuar në masën 94%. Janë planifikuar fonde për financimin e 8 projekteve të investimit, nga të cilat 3 projekte janë financuar pjesërisht, 1 projekte nuk është realizuar dhe 4 projekte janë financuar plotësisht sipas planit të vitit.

Planifikimi dhe realizimi i investimeve 2024:

Tabela nr.11: Shpenzime për projekte llogaria 230

Nr	Programi	Kodi	Emertimi	Plan	Fakt	%
1	04240	1100126	Projekt Reabilitime Kanale Ujitese	486,000	114,000	23
2	04240	1100214	Projekt Ujesjelles Klos	914,000	914,000	100

3	4260	1100229	Plani Reab.Ekonomise Pyjore Mollas	1,449,960	1,449,960	100
4	4520	1100128	Projekte Rruge te Brendshme	300,000	0	0
5	4520	1100132	Projekte elektrik	200,000	118,800	59.4
6	4520	1100133	Projekt.Rik.sistemim Asfalti Rruge	2,300,000	2,300,000	100
7	06260	1100250	Plan I Pergjithshem Vendor	1,725,000	218,440	12
8	6260	1100268	Projekt Varreza	819,419	819,419	100
			Shuma Projekte	8,194,379	5,934,619	72.4

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr.12: Shpenzime investime nga të ardhurat e Bashkisë Cërrik:

Nr	Programi	Kodi	Emërtimi	Plan	Fakt	%
1	1110	1100169	Pajisje per mbrojtje ndaj zjarrit	862,200	142,200	16.4
2	1110	1100137	Pajisje te tjera	600,000	600,000	100
3	1110	1100010	Blerje Pajisje Elektronike	1,996,800	1,996,800	100
4	03280	1100180	Blerje Pajisje	1,000,000	1,000,000	100
5	03280		Rimbursim TVSH	892,182	892,182	100
6	4240	1100269	Reabilitim Kanale Ujitese Shtepanjë	6,550,167	6,550,167	100
7	4520	1100146	Mbikqyrje Rruga Shtermen dhe KUZ	89,849	0	0
8	4520	1100164	Rikonstruksion Rruge Rurale(Zdravo)	4,000,000	4,000,000	100
9	4520	1100164	Rikonstruksion Rruge Çameria	7,999,950	7,999,950	100
10	4520	1100201	Kolaudim rruga Rurale	380,000	328,200	86.3
11	4520	1100202	Supervizim rruge Rurale	1,500,000	1,487,935	99.1
12	4520	1100203	Rikonstruksion Rruge Qyrkan	2,000,000	1,999,999	100
13	4520	1100209	Rikonstruksion Rruge Kamunah	6,755,192	6,755,192	100
14	4520	1100215	Rikonst.i 3 rrugeve Lagja nr.3	2,619,345	2,618,598	99.9
15	4520	1100216	Rikonstruksion Rruge Rurale	6,000,000	0	0
16	4520	1100224	Rikonstruksion rruga Lushallinjve	5,000,000	5,000,000	100
17	4520	1100251	Rikonstruksion Rruge Cërrik-Malasej	10,000,000	10,000,000	100
18	4520	1100252	Rikonstruksion Rruge Shales Lazarec	3,436,006	3,436,006	100
19	4520	1100253	Ndertim Kuz dhe Rruge Shtermen	10,738,301	10,738,301	100
20	4520	1100254	Rikonst.Rruges se Pllakallinjve Gostime	13,769,190	13,769,190	100
21	4520	1100255	Rikonstruksion I Rruges Fshat Dasar	5,433,900	5,433,900	100
22	4520	1100256	Rikonst.Rruge Klos se Delinjve	7,003,658	7,003,658	100
23	6140	M100397	Reabilitim Banesa Ekzistuese Kom	2,560,000	2,560,000	100
24	6140	1100028	Mbikqyrje Punimesh	556,017	556,017	100
25	6260	1100230	Kol.Rikual.Urban Blloku I Lagja I	120,000	0	0
26	6260	1100231	Mbik.Rikual.Urban Blloku I Lagja I	40,000	0	0
27	6260	1100259	Rikualifikim Urban Blloku I Lagja I	8,610,352	8,610,352	100
28	6260	1100118	Pike Lidhje Energjie	38,745	38,745	100
29	6260	1100144	Kendi I Lojrave	1,650,075	1,650,075	100
30	6260	1100206	Konstruksione te Rrjeteve	55,780	55,780	100
31	8130	1100271	Kompleksi Sportiv Shtermen	6,000,000	6,000,000	100
32	9120	1100238	Rikonstruksion Shkolla Selite	10,331,650	10,331,650	100
33	3280	A000004	Blerje zjarrfikese&Pajisje	8,892,000	8,892,000	100
34	9120	1100170	Kende Loj,Palester e Jashtme	143,520.64	143,520	100
			Shuma 231	137,624,879.6	130,590,417	94.8
			Totali 230+231	145,819,258.6	136,525,036	93.6

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Cërrik së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024 kanë diferencë me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2024 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 525,678 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 507,376 mijë lekë, ose në masën 96 %.

Duke marrë në konsideratë dhe fondet e kushtëzuara për vitin 2024 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 1,062,863 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 994,878 mijë lekë, ose në masën 93 %.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2024 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 137,625 mijë lekë, realizuar 130,591 mijë lekë, ose në

masën 95% dhe nga të ardhurat e kushtëzuara janë planifikuar në vlerën 135,953 mijë lekë, realizuar 90,228 mijë lekë, ose në masën 66%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Cërrrik në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2024 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është në total në shumën 11,632 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr.87 datë 27/12/2023 “Për miratimin e buxheti vjetor 2024 dhe PBA 2024-2026 i Bashkisë Cërrrik”, dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.07 datë 15/01/2024.

b. Fondet e emergjencës.

Në bazë të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 65, nga Ministria e Mbrojtjes (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) Bashkia Cërrrik ka përfitur fonde. Bazuar në VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” dhe me VKB përkatëse është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira, duke i detajuar ato, sipas zërave të shpenzimeve dhe më pas është kryer prokurimi i tyre, sipas të cilave janë kryer shpenzimet.

Për vitin 2024 me shkresën nr. 1036/1, datë 25/06/2024, të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” Bashkisë Cërrrik i është akorduar *fondi në vlerën 15,484,779.8 lekë*. Dhe me shkresën nr.1446/2, datë 20/02/2024 është akorduar fondi prej 4,349,423 lekë nga të cilat për shpenzime për masa parandaluese lehtësuese dhe mbrojtëse 2,349,423 lekë dhe për banesat të dëmtuara 2,000,000 lekë.

Tabela nr. 10: Përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Shpenzime për mirëmbajtjen e Objekteve Administrative qe rrezikohen te dëmtohen.	2,000,000	0	2,000,000
2	Shpenzime për Mirëmbajtje te Objekteve te Familjeve në Nevojë,	2,349,423	2,349,423	0
3	Ndërtim Prita Malore Mollas- Selit faza e parë	15,484,800	15,484,780	0
	Total	19,834,223	17,834,203	2,000,000

Burimi: Bashkia Cërrrik

Gjatë vitit 2024 nga fondet e bashkisë janë përdorur edhe 0 lekë për ndihmë financiare familjeve të dëmtuara nga zjarri.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Për vitet 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.

Për vitin 2024 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si mëposhtë:

Raport monitorimi Janar-Prill 2024 me shkresën nr.1360, datë 31/05/2024.

Raport monitorimi Janar-Gusht 2024 me shkresën nr.2273, datë 30/09/2024.

Raporti monitorimi periudha Janar-Dhjetor 2024 është dërguar me shkresën nr.642, datë 28/02/2025.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj).

Detyrimet e prapambetura viti 2024:

Bashkia Cërrik në datën 01.01.2024 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 135,064,467 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2024 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2024 vlera 54,159,467 lekë si mëposhtë.

Tabela nr. 13: Informacion për planifikimin e likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara 2024	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2024	135,064,467	54,159,467	Nr.87,date 27/12/2023	3,794,213	50,365,254

Burimi: Bashkia Cërrik

Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 29,171,309 lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 48,282,600 lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2024 është në vlerën 115,953,175 lekë.

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta Bashkia Cërrik nuk duhet të marrë angazhime të reja buxhetore, fillimisht duhet të shlyeje detyrimet nga kontrata e mëparshme. Për këtë duhet të rishikohet edhe buxhetit i vitit të ardhshëm duke pakësuar disa nga investimet e parashikuara për mos të patur përkeqësim të situatës së detyrimeve të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55 “Probleme financiare”

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2024 -31.12.2024, ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Cërrik z. A. S. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. H. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Tabela Nr. 14: Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2024:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2023	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2024	Total detyrime	Shlyerja gjate vitit 2024	Mbetja në fund të vitit 2024
A	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSH (AKUM, etj)	36,236,536	0	36,236,536	0	36,236,536
b. Investime nga Bashkia	131,270,253	22,708,440	153,978,693	47,449,196	106,529,497
INVESTIME	167,506,789	22,708,440	190,215,229	47,449,196	142,766,033
Mallra dhe shërbime	3,794,213	6,462,869	10,257,082	833,404	9,423,678
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0
Totali	171,301,002	29,171,309	200,472,311	48,282,600	152,189,711

Burimi: Bashkia Cërrik**Plan Rehabilitimi për daljen nga situata e Vështirësisë Financiare:**

Me shkresën nr.2272/1 prot, datë 30.09.2024 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Cërrik i është drejtuar Këshillit Bashkiak me planin për rehabilitimin dhe daljen nga vështirësia financiare. Vlera e raportuar e detyrimeve të prapambetura e raportuar në MFE në datën 31.12.2023 është në vlerën 135,064,466 lekë, konfirmuar kjo vlerë sipas shkresës nr, 437, datë 09.02.2024.

Tabela Nr. 15: Detyrimet e krijuara sipas vjetërsisë gjenden në tabelën më poshtë:

Nr	Viti i detyrimeve	Detyrime 31.12.2022	Detyrime 31.12.2023	Ndryshimi
1	31.12.2015	15,072,622	14,018,369	(1,054,253)
2	31.12.2016	3,000,000	3,000,000	0
3	31.12.2017	354,166	354,166	0
4	31.12.2018	1,929,736	1,929,736	0
5	31.12.2019	10,921,336	4,720,136	(6,201,200)
6	31.12.2020	29,795,015	21,843,395	(7,951,620)
7	31.12.2021	8,196,892	7,605,192	(591,700)
8	31.12.2022	54,987,245	42,637,125	(12,350,120)
9	31.12.2023	0		
Detyrimi Progresiv		121,557,012	135,064,466	13,507,454

Burimi: Bashkia Cërrik

Referuar analizës së mësipërm nga Bashkia Cërrik është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve për periudhën qershor 2024-qershor 2025.

Tabela Nr. 16: Plani i shlyerjes së detyrimeve gjenden në tabelën më poshtë:

Detyrimi	Faza e parë qershor 2024 (likuidimet)	Faza e dytë dhjetor 2024 (likuidimet)	Faza e tretë qershor 2025 (likuidimet)	Detyrimi 30.06.2025
135,064,477	12,715,382	37,676,413	32,465,800	87,698,022

Burimi: Bashkia Cërrik**Vështirësia Financiare e Bashkisë Cërrik.**

Referuar shkresës nr. 437 prot., datë 09/02/2024 “Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2023, Bashkia Cërrik” të dërguar në MF dhe sipas publikimit në faqen e saj detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 135,064,466 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2024 detyrimet e prapambetura të raportuara me shkresën nr.prot. 641 prot., datë 28/02/2025 dhe të publikuara në faqen e MF paraqiten në shumën 115,953,175 lekë. Gjatë vitit 2024 janë krijuar 29,171,309 lekë detyrime dhe është likuiduar vlera 48,282,600 lekë. Vlera e detyrimit të mbetur të palikuiduar në fund të vitit 2024 është 152,189,711 lekë e ndarë:

- Detyrime te ministrive të linjës 26 në shumën 36,236,536 lekë.
- Detyrime Bashkia Cërrik 115,953,175 lekë.

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2024 janë të palikuiduara gjithsej 58 fatura me vlerë 11,5953,175 lekë. Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në aneksin nr.2/2/4 në anekset e projekt raportit të auditimit.

Detyrimet e Prapambetura:

Detyrimet e prapambetura për vitin 2023 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr.437 prot., datë 09/02/2024 dhe detyrimet e prapambetura për periudhën janar-dhjetor 2024 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr.641 prot., datë 28/02/2025 jepen në tabelën si më poshtë:

Tabela Nr. 17: Stoku i borxhit i raportuar në MFE

NR	Emërtimi	Viti 2023			Viti 2024		
		Stoku në vlerë në fund te vitit 2023	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së	Stoku në vlerë në fund te vitit 2024	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)						
a	Hua afatgjatë						
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)						
a.2	Tituj të emetuar						
a.3	Garanci për të tretë						
b	Hua afatshkurtër						
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)						
b.2	Tituj të emetuar						
b.3	Garanci për të tretë						
II	Detyrimet e prapambetura	135,064,466		29.39	115,953,175		22.85
Llogaria ekonomia	Emërtimi						
4864100	Vendime Gjyqësore						
4864200	Det.Prap. Sherbime	1,304,824			3,917,170		
4864201	D.P.EneriElektirke						
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	417,936			417,936		
4864400	Det.Prap. Investime	131,270,253			106,529,497		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH						
4864600	Mallra	2,071,453			5,088,572		
4864900	Det.Prap.Te Tjera						
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore						
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet						
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal						
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera						
4864901	Paga						
4864902	Shpronetime						
4864903	Trans.indiv						
4864904	Trans.Subjektet						
III	Totali (I+II)	135,064,466	459,607,245	29.39	115,953,175	507,376,266	22.85

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela Nr. 18: Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2023	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2024	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2024	Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2024	Detyrimi në lekë më 31.12.2024
Dëshmperblim page për punonjësit e larguar nga puna	0	2	1,592,378	1,592,378	0
Dëshmperblim pension invaliditeti	0	1	301,435	301,435	0

Burimi: Bashkia Cërrik

Bashkia Cërrik për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 ka shpenzuar vlerën 1,893,813 lekë, e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim i përket vendimeve për punonjësit e larguar nga puna dhe pensione të invaliditetit këto fonde do të mbulojnë nga Ministria e Shëndetësisë sepse i përket pagesave të kryera nga Ministria e Shëndetësisë për invalidët për periudhën 2005-2010.

Vlera totale **1,592,378 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024 nga Bashkia Cërrik, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Tabela Nr. 19: Paraqiten në mënyrë analitike lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme.

Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit të Gjykatës	Gjendja e palikujduar	Vendime të ardhura gjatë vitit 2024		Detyrim i total	Likujduar	Gjendja e palikujduar më 31.12.2024		
				31/12/2023	Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit		ne vitin 2024	9	10=8-9	
1	2	3	4	5	6	7	8=5+7	9	10=8-9		
Dëmshpërblim page											
V	Sh	Nr. 174 date 26.05.2022	Page	1,232,378	0	Nr. 174 date 26.05.2022	1,232,378	1,232,378	1,232,378	0	0
B	A	Nr. 648 date 06.02.2024	Page	360,000	0	Nr. 648 date 06.02.2024	360,000	360,000	360,000	0	0
Dëmshpërblim invalidët											
Q. shpk		Nr. 143 date 12.01.2024	Pension invaliditeti	301,435	0	Nr. 143 date 12.01.2024	301,435	301,435	301,435	0	0

Burimi: Bashkia Cërrik

2.5.Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR dhe Ministrive, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Cërrik ka 6(gjashtë) kontrata aktive të cilat janë më bashkëfinancim me Ministrinë e Linjës. Projektet e financuara i përkasin periudhës 2022-2024 si mëposhtë:

Tabela Nr. 20: Projektet e investime të financuara nga Ministrinë e Linjës:

Ministria	Llog	Kodi	Investimi	Kontrata	Vlera e Kontratës	Plan 2024	Fakt 2024	% realizimit	Statusi
17	231	18AZ901	Prita Mbrojtëse	08.10.2024	42,878,511	15,484,780	15,484,780	100	Përfunduar
11	231	22AC512	Rikonstruksion Shkolle	13.09.2023	96,685,926	39,367,648	38,642,945	98.1	Përfunduar
11	231	M112551	Paisje për shkolla	04.12.2023	1,978,320	1,978,320	1,978,320	100	Përfunduar
12	231	24AB504	Rikonstruksion Konvikti	26.12.2024	83,213,174	45,000,000	0	0	Proces
12	231	M100399	Përmirësim Banesash	18.10.2023	45,235,456	14,122,323	14,122,323	100	Përfunduar
5	231	18AJ956	Kanale ujitëse	17.07.2024	54,974,453	20,000,000	20,000,000	100	Proces

Total			324,965,840	135,953,071	90,228,368	
-------	--	--	-------------	-------------	------------	--

Burimi: Bashkia Cërrrik

2.6. Burimi i krijimit i të ardhurave . Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave . Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

1. Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e Bashkisë Cërrrik e aplikuar për vitin 2024 është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 797, datë 20.12.2023, me objekt “Për miratimin e strukturës, organigramës së administratës së bashkisë dhe të njëjstëve shpenzuese në varësi të Bashkisë Cërrrik” në të cilën përfshihet edhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave (në vijim DTT) e ndarë në dy sektorë, Sektorin e Taksave dhe Tarifave të Bizneseve dhe Sektorin e Taksave dhe Tarifave Familjare e përbërë nga 20 (njëzetë) pozicione dhe paraqitet në **aneksi nr. 2/2/6/1 në anekset** e raportit të auditimit.

2. Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Cërrrik për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, është miratuar me Vendimin nr. 90, datë 27.12.2023, të Këshillit Bashkiak me objekt “Për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2024”.

Tabela Nr. 21: Paraqitet parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Cërrrik për vitin 2024 paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

000/lekë						
Nr.	Emërtimi	Plani 2024	Fakti 2024 Total	% e realizimit/plan	Fakt familjarë	Fakt biznes
A	Të ardhurat nga taksat	91,823	78,434	85.8	27,277	19,417
1	Taksa mbi ndërtesën	28,500	22,063	77.41	12,880	9,183
2	Taksa mbi tokën bujqësore	16,300	13,290	81.53	13,290	0
3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	7,320	1,497	20.45	0	0
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	10	50	500.00	0	0
5	Taksa e rregjistrimit të automjeteve	14,500	15,189	104.75	-	-
6	Taksë tabele	1,200	427	35.58	0	427
7	Taksa e Rentës minerale	40	70	175.00	-	-
8	Taksa e truallit	7,890	8,924	113.11	720	8,204
9	Tatim i thjeshtuar i biznesit të vogël	320	95	29.69	0	95
10	Taksë tregu	2,650	1,874	70.71	-	-
11	Takse e perkohshme Infrastruk.arsimore	1,800	1,870	103.89	387	1,483
12	Taksa e pulles	45	20	44.44	-	-
13	Takse ne sherbimim hotelier	25	25	100	-	25
14	Taksë rregjistrimi biznesi	-	-	-	-	-
15	Tatim mbi të ardhurat personale TAP	11,200	13,040	116.43	-	-
16	Taksa te tjera	23	0	-	-	-
B	Të ardhurat jo tatimore	81,060	61,171	75.46	9,840	18,225
1	Tarifa e pastrimit	22,650	20,157	88.99	8,030	12,127
2	Tarifa për hapsirat publike	-	-	-	-	-
3	Tarifa e ndriçimit	2,600	2,040	78.46	1,060	980
4	Tarifa e gjelbërimit	1,850	1,819	98.32	750	1,069
5	Tarifa për reklamë	-	-	-	-	-
6	Tarifa për parkim	1,010	1,160	114.85	-	1,160
7	Tarifa e licensimit te veprimtarise transp.	400	1,168	292.00	-	1,168
8	Tarifa e shërbimit veterinar	-	-	-	-	-
9	Tarifa për shërbime të tjera administrative	380	103	27.10	-	-
10	Tarifa për dhënie leje licensa dhe autorizime	1,160	1,721	148.36	0	1,721

11	Tarifë ndotje mjedisi	-	-	-	-	-
12	Tarifë mirëmbajtje vaditje kullim	1,750	1,919	109.66	-	-
13	Tarifa per sherbimet zjarrfikese	260	75	28.85	-	-
14	Tarifa te kontrollit te zhvillimit te teritori	5,660	3,463	61.18	-	-
15	Qira toke	9,000	5,920	65.77	-	-
16	Qira fondi pyjor,kullusor	8,490	4,988	58.75	-	-
17	Qira ndërtese	810	696	85.93	-	-
18	Dhurata dhe sponsorizime	3,000	-	-	-	-
19	Të ardhura nga gjobat	2,500	4,417	176.68	-	-
20	Të ardhura nga pagesat kopësht dhe çerdhe	-	-	-	-	-
21	Sekuestri dhe zhëmtime	-	1,525	-	-	-
22	Të tjera jotatimore	-	-	-	-	-
23	Grant nga nivele të tjera	-	10,000	-	-	-
24	Transferta dhe ndihma nga njesite e tjera	1,000	-	-	-	-
25	Tarifa te tjera	18,540	-	-	-	-
26	Tarifa për shërbim komunitar	-	-	-	-	-
Totali		172,883	139,605	80.75%	37,117	37,642

Burimi i të dhënave: Bashkia Cërrik

Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën **172,883 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **139,607 mijë lekë** referuar Akt-Rakordimit të datës 25.01.2025, me Degën e Thesarit Cërrik ose në masën **80.7%** me një diferencë mos realizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **33,276 mijë lekë**. Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- “Taksa e rregjistrimit të automjeteve” është planifikuar në vlerën 14,500 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 15,189 mijë lekë ose realizuar në masën 105%.
- “Tatim mbi të ardhurat personale TAP” është planifikuar në vlerën 11,200 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,040 mijë lekë ose realizuar në masën 116%.
- “Taksa e truallit” është planifikuar në vlerën 7,890 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,924 mijë lekë ose realizuar në masën 113%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- “Tarifë e pastrimit” është planifikuar në vlerën 22,650 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 20,157 mijë lekë ose realizuar në masën 89%.
- “Taksa mbi token bujqësore” është planifikuar në vlerën 16,300 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,290 lekë ose realizuar në masën 81%.
- “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 7,320 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,497 mijë lekë ose realizuar në masën 20%.
- “Taksë ndërtese” është planifikuar në vlerën 28,500 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 22,063 mijë lekë ose realizuar në masën 77%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga DTT nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Cërrik që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200.

3. Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të aplikuar për vitin 2024 nga Bashkia Cërrik, miratuar me urdhrin nr. 50 prot., datë 27.01.2023, nga Kryetari i Bashkisë me objekt “Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Cërrik”, nuk është caktuar personi përgjegjës i cili ka për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (ASHK Elbasan për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale, DSHTRR Elbasan në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura dhe Dega e Doganës Elbasan për rentën minerare) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Cërrik dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Cërrik duke kuadruar me akt-rakordimin e datës 16.01.2025.

Tabela Nr. 22: Paraqiten të ardhurat e arkëtuara nga agjentët tatimorë për vitin 2024.

000/lekë				
Nr.	Emërtimi	Plani 2024	Realizimi 2024	% e Realizimit/Planin
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (DRT)	320	95	30%
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (DRT)	11,200	13,040	116%
3	Taksa e rregjistrimit të automjeteve (DSHTR)	14,500	15,189	105%
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (ASHK)	10	50	500%
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)	40	70	175%
Totali		26,070	28,444	

Burimi: Bashkia Cërrik

Për sa trajtuar më sipër Bashkia Cërrik i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Cërrik por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Cërrik, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë

me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

4. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Cërrik kryhet në programin Excel. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve disponon regjistra fizik por në këto regjistra paraqitet informacion vetëm për pagesat e kryera nuk disponohet informacion për abonentë familjarë debitorë. Gjithashtu për abonentët të cilët janë të përjashtuar nga taksat dhe tarifatat vendore sipas paketës fiskale me nr.90, datë 27.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2024” nuk është regjistruar statusi i tyre “pensionist”, “ndihmë ekonomike” etj.

Informacioni i azhornuar për abonentët familjarë gjendet vetëm në regjistrat elektronikë në formatin excel.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2024, Bashkia Cërrik nuk ka pasur akt-marrëveshje me “Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Elbasan Sh.a”, taksat dhe tarifatat vendore sipas paketës fiskale abonentët e Bashkisë Cërrik i bëjnë pagesat në bankë në zyrën e Postës Shqiptare ose në arkën e Bashkisë Cërrik.

5. Abonentët Familjarë:

Referuar të dhënave që disponohen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Cërrik abonentët familjarë ndahen sipas qytetit dhe njësisive administrative si mëposhtë:

Tabela Nr.23: Numri i abonentëve familjarë i ndarë sipas zonave

Nr	Qyteti/Njësia	Nr. Abonentëve familjarë
1	Cërrik	2,559
2	Mollas	961
3	Gostime	2,206
4	Klos	745
5	Shalës	1,088
Total		7,559

Burimi:Bashkia Cërrik

Referuar VKB nr.90, datë 27.12.2023, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2024” abonentët familjarë në Bashkinë Cërrrik janë ngarkuar si mëposhtë për taksat dhe tarifavat vendore.

Tabela Nr.24: Llojet e taksave për abonentët familjarë.

Nr	Lloji i Taksës	Vlera në lek(Qytet)	Vlera në lek Njësia
1	Ndërtese për banim	19.15 lek/m ²	19.15 lek/m ²
2	Ndërtesë e privatizuara	13.4 lek/m ²	13.4 lek/m ²
3	Taksë trualli	0.14 lek/m ²	0.14 lek/m ²
4	Tarifë pastrimi	1,200	1,200
5	Tarifë ndriçimi	300	200
6	Tarifë gjelbërimi	250	150
7	Tarifë e përkohëshme arsimore	100	100

Burimi: Bashkia Cërrrik

Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale abonentët familjarë:

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të ardhurave Vendore Bashkia Cërrrik janë verifikuar regjistrat elektronike për qytetin e Cërrrikut.

Referuar të dhënave në marra nga regjistri elektronik sepse nga regjistri fizik nuk disponohet informacion për ngarkesën fiskale dhe debinë e tyre u konstatua se për tarifavat vendore abonentët familjarë janë ngarkuar në përputhje me paketën fiskale nr.90, datë 27.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2024”. Për taksën e ndërtesës u audituan abonentët të cilët sipas rregjistrat elektronik nuk janë ngarkuar me taksën e ndërtesës referuar paketës fiskale. Për këta abonentë disponohet informacioni nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan ku verifiohet se këta abonentë trajtohen me pension pleqërie dhe referuar certifikatave familjare janë kryefamiljarë pensionistë.

Në aneksin nr.2/2/6/2 në anekset e raportit të auditimit paraqiten abonentët familjarë për të cilët është audituar dokumentacioni për taksën e ndërtesës.

Menaxhimi i borxhit

Abonentët familjarë në Bashkinë Cërrrik dhe në Njësitë Administrative tarifohen me taksa dhe tarifa vendore në bazë të VKB nr. nr.90, datë 27.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2024”.

Njoftimet për taksat dhe tarifavat vendore përgatiten nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore brenda muaj prill të vitit fiskal. Njoftimet dorëzohen dorazi dhe me postë për shkak të volumit të lartë të abonentëve familjarë. Abonentët debitorë paguajnë pranë arkave të zyrave të njësive administrative.

Abonentët debitorë familjarë janë njoftuar me formularin “Njoftim dhe Kërkesë për të Paguar (aneksi A - Formulari MSh001), kur taksapaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij, lidhur me taksat e tarifavat vendore”, në përputhje me Udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriaale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore”.

Pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) ditë pune nga dërgimi i dokumentit të “Njoftim dhe Kërkesë për të paguar” nga titullari i NJVV duhet të nxirret urdhri i bllokimit. Nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Cërrrik është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriaale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore” pika 2 urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit. Abonentët familjarë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Cërrrik paraqiten në fund të

vitit 2023 për vlerën 37,524,202 lekë. Gjatë vitit 2024 pagesa për detyrime nga taksat dhe tarifat vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 8,919,630 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 28,604,572 lekë gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 15,313,617 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2024 është në vlerën 43,918,189 lekë nga taksat dhe tarifat për abonentët familjarë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

Tabela nr.25: Detyrimet e familjarëve sipas taksave dhe tarifat vendore dhe numrit të familjeve debitore të vitit ushtrimor 2023 si vijon:

Lekë

Detyrimet deri më 31.12.2023									
Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit	Taksë truallit	Tarifë ndriçimi	Tarifë gjelbërimi	Taksë arsimit	Totali
1	Njësia Cërrik	405,000	3,725,341	3,207,609	43,517	1,402,046	261,270	164,100	9,208,883
2	Njësia Gostimë	2,629,986	2,942,601	1,410,440	49,040	382,250	71,100	93,800	7,579,217
3	Njësia Mollas	2,265,998	1,626,587	817,501	23,401	1,180	820	62,902	4,798,389
4	Njësia Shalës	3,581,910	3,673,213	1,256,300	51,610	9,910	1,260	118,000	8,692,233
5	Njësia Klos	2,613,395	3,180,669	1,208,500	48,666	105,320	11,130	77,800	7,245,480
Totali		11,496,289	15,148,411	7,900,350	216,234	1,900,706	345,610	516,602	37,524,202

Burimi: Bashkia Cërrik

Tabela nr.26: Detyrimet e familjarëve sipas taksave dhe tarifat vendore për vitin ushtrimor 2024 si vijon:

Lekë

Detyrimet deri më 31.12.2024									
Nr	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit	Taksa e truallit	Tarifa e ndriçimi	Tarifa e gjelbërimi	Taksë arsimit	Totali
1	Njësia Cërrik	376,990	4,087,290	3,583,000	48,470	1,372,150	424,500	216,600	10,109,000
2	Njësia Gostimë	3,061,708	3,680,055	1,791,400	61,920	402,050	151,200	132,000	9,280,333
3	Njësia Mollas	2,625,387	2,098,752	1,054,600	29,580	2,200	0	98,900	5,909,419
4	Njësia Shalës	4,291,743	4,326,020	1,592,100	61,230	14,600	0	161,400	10,447,093
5	Njësia Klos	2,818,935	3,606,709	1,430,600	55,050	159,350	0	101,700	8,172,344
Totali		13,174,763	17,798,826	9,451,700	256,250	1,950,350	575,700	710,600	43,918,189

Burimi: Bashkia Cërrik

Tabela nr.27: Detyrimet e familjarëve sipas taksave dhe tarifat vendore dhe numrit të familjeve debitore të vitit ushtrimor 2024 si vijon:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Deri më datën 31.12.2023	Detyrime deri më 31.12.2023 (zbritur pagesat e 2024)	Viti 2024	Totali progresiv	Numri i familjeve debitore
1	Taksa e tokës bujqësore	11,496,289	8,620,021	4,554,742	13,159,122	
2	Taksa e ndërtesës	15,148,411	11,628,585	6,165,105	17,809,331	
3	Tarifa e pastrimit	7,900,350	6,071,540	3,384,000	9,455,540	
4	Tarifa e ndriçimit	1,900,706	1,474,906	476,400	1,951,306	
5	Tarifa e gjelbërimin	345,610	251,000	324,700	575,700	
6	Taksa e arsimit	516,602	389,650	321,100	710,750	
7	Taksa e truallit	216,234	168,870	87,570	256,440	
Totali		37,524,202	28,604,572	15,313,617	43,918,189	3,820

Burimi: Bashkia Cërrik

Taksa e tokës bujqësore:

Bashkia Cërrrik për vitin 2024 ka parashikuar të arkëtoi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 16,300 mijë lekë realizimi i kësaj takse për vitin 2024 është në vlerën 9,724 mijë lekë. Sipas të dhënave që disponon Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Bashkinë Cërrrik sipërfaqja totale e tokës bujqësore i përket 6,124 familjeve dhe sipërfaqja e ndarë e tokës është 6,792 ha.

Në **Tabelën nr.28** paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Cërrrik.

000 lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Numri familjeve që kanë marrë AMTP	Sipërfaqja e tokës ndarë në fakt ligji nr. 7501	Kategoria e tokës e ndarë sipas Ligjit nr. 7501/në hektar						
				I	II	III	IV	V	VI	VII
1	Njësia Cërrrik	1,320	557.08	0	311.27	114.57	0	131.24	0	0
2	Njësia Gostimë	2,273	2,134.43	0	560.8	606.25	351.19	167.97	177.78	270.44
3	Njësia Mollas	1,051	1,556.33	0	0.14	979.88	261.21	46.7	63.1	205.3
4	Njësia Shalës	832	1,857.16	0	127.48	327.76	318.38	259.2	456.3	368.04
5	Njësia Klos	653	687.77	0	10.7	217.3	75.79	177.75	185.49	20.74
Shuma		6,129	6,792.77	0	1010.39	2245.76	1006.57	782.86	882.67	864.52
Cnimi sipas VKB				4,200	3,500	2,800	2,300	1,900	1,600	1,400
Vlera e parashikuar per tu arkëtuar				0	3,536,000	6,288,000	2,315,111	1,487,434	1,412,272	1,210,328

Burimi: Bashkia Cërrrik

Abonentët familjarë debitorë për taksën bujqësore në njësitë administrative dhe në qytetin e Cërrrikut paraqiten në fund të vitit 2023 për vlerën 11,496,289 lekë. Gjatë vitit 2024 pagesa për taksën bujqësore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 2,876,268 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 8,620,021 lekë, gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 4,554,740 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2024 është në vlerën 13,174,763lekë i cili i përket 3,820 familjeve.

Në **tabelën nr. 29:** Paraqiten debitorët për taksën e tokën bujqësore

Lekë

Nr	Njësia	Debia deri 2023	Detyrime deri më 31.12.2023 (zbr pagesat e 2024)	Debia progresive 31.12.2024
1	Cërrrik	405,000		376,990
2	Njësia Administrative Gostimë	2,629,986		3,061,708
3	Njësia Administrative Mollas	2,265,998		2,625,387
4	Njësia Administrative Shalës	3,581,910		4,291,743
5	Njësia Administrative Klos	2,613,395		2,818,935
Total		11,496,289	8,620,021	13,174,763

Punoi: Grupi i Auditimit

6. Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Cërrrik nuk disponon sistem elektronik për administrimin dhe regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë në Bashkinë Cërrrik.

Të dhënat e abonentëve privatë janë të rregjistruara në exel. Vetëm për biznesin e vogël disponohen rregjistra fizikë ndërsa për biznesin e madh, i cili ka ngarkesën më të madhe fiskale nuk disponohen rregjistra fizik dhe vetëm elektronikë e cila sjell risk të shtuar për institucionin.

Në **tabelën nr. 30:** Paraqitet situata e lëvizjes se subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrrik bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qytet	1	Biznesi i Madh	2024	73	7	8	72
Qytet	2	Biznesi i Vogël	2024	187	16	6	197

Total 1 + 2				260	23	14	269
NJA	3	Biznesi i Madh	2024	66	0	1	65
NJA	4	Biznesi i Vogël	2024	266	25	17	274
Total 3 + 4				332	25	18	339

Burimi:Bashkia Cërrrik

Nga auditimi i listës së subjekteve të cilat gjatë vitit 2024 kanë aplikuar për mbyllje/pezullim/riaktivizimi aktiviteti janë paraqitur në aneksin nr.2/2/6/3 në anekset e raportit të auditimit.

Nga verifikimi i këtyre aplikimeve në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB) këto subjekte rezultojnë me të njëjtin status.

Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale abonentët biznes:

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të ardhurave Vendore Bashkia Cërrrik janë verifikuar regjistrat elektronike për biznesin e madh.

Referuar të dhënave në marra nga regjistri elektronik sepse nga regjistri fizik nuk disponohet informacion për ngarkesën fiskale dhe debinë e tyre u konstatua se për tarifën vendore abonentët privatë janë ngarkuar në përputhje me paketën fiskale nr.90, datë 27.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2024”.

Nga rregjistri elektronik u verifikuan të dhënat për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit. Tarifa e pastrimit për biznesin e madh është ngarkuar në përputhje me paketën fiskale të Bashkisë Cërrrik.

7. Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifën vendore:

Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet si biznes i vogël dhe biznes i madh në vlerën **13,871,855 lekë**. Përgjatë vitit 2024 për llogari të detyrimeve që i përkasin vitit 2023 është likuiduar vlera 2,161,867 lekë si dhe janë krijuar debitorë në vlerën 5,360,059 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2024, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën **17,070,047 lekë, borxhi tatimor është i kontabilizuar.**

Në tabelën nr. 31: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Njësitë Administrative	Deri më datë 31.12.2023	Deri më datë 31.12.2023 (zbritur pagesat e 2024)	Lekë		Nr i subjekteve debitore
				2024	Totali progresiv	
1	Subjektet fizik biznesi i vogël	4,552,627	2,716,949	1,420,134	4,137,083	64
2	Subjektet juridik biznesi i madh	9,319,228	8,993,039	3,939,925	12,932,964	22
Total		13,871,855	11,709,988	5,360,059	17,070,047	86
1.1	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Cërrrik	1,709,942	1,077,844	634,914	1,712,758	27
1.2	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Gostimë	1,666,020	982,665	333,070	1,315,735	17
1.3	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Mollas	388,832	106,442	95,580	202,022	6
1.4	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Shalës	450,359	265,748	238,020	503,768	9
1.5	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administraive Klos	337,474	284,250	118,550	402,800	5
Totali		13,871,855	11,709,988	5,360,059	17,070,047	86

Burimi:Bashkia Cërrrik

Në lidhje me këtë situatë DTT e Bashkisë Cërrrik për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të kosiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast

nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 181 “Mos pagimi i taksës dhe tatimeve”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, ku përcaktohet që: “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore” si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 3, pikat 9-10.

8. Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Dega Elbasan janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Nga auditimi konstatohet se deri më datë 31.12.2024, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është në vlerën 20,682,982 lekë për 497 përfitues. Përgjatë vitit 2024 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 2,304,860 lekë për 47 persona nga e cila është arkëtuar vlera 313,218 lekë dhe janë krijuar debitorë në vlerën 1,991,642 lekë, ndërsa gjendja debitoare më datë 31.12.2024, është në vlerën **20,682,982 lekë për 497 persona.**

Në tabelën nr. 32: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë						
Viti	Persona	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Nr. i personave	Vlera e arkëtuar	Nr. i personave	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2023	533	21,606,332	55	1,914,175	478	19,692,157
Deri më datë 31.12.2023 (zbritur pagesat 2024)	478	19,692,157	20	1,000,817	458	18,691,340
2024	47	2,304,860	8	313,218	39	1,991,642
Totali/Progresiv	525	21,997,017	28	1,314,035	497	20,682,982

Burimi: Bashkia Cërrik

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se nga Bashkia Cërrik për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK Elbasan për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

9. Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Cërrik dhe njësisive administrative është

ushtuar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 11 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Cërrik të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa licencë, kërkesë për bashkëpunim nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15.

Në tabelën nr. 33: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	“G.C”sh.p.k.	K6	25.11.2020	25.11.2025	1,000,000	1,000,000	0
2	“G.C”sh.p.k.	K6	-	-	-	-	-
3	“K” sh.p.k.	J61	03.02.2022	03.02.2027	1,000,000	1,000,000	0
4	“G.O”sh.p.k.	L53	16.12.2020	16.12.2025	1,000,000	800,000	200,000
5	“G.O”sh.p.k.	L53	11.12.2020	11.12.2025	1,000,000	400,000	600,000
6	“F” sh.p.k.	L33	-	-	-	-	-
7	“D.O”sh.p.k.	L42	22.09.2019	22.09.2024	1,000,000	600,000	400,000
8	“X. O”sh.p.k.	L42	16.09.2019	16.09.2024	1,000,000	800,000	200,000
9	“L.O”sh.p.k.	L52	06.03.2022	06.03.2027	1,000,000	600,000	400,000
10	“D”sh.p.k.	M02	06.08.2020	06.08.2025	1,000,000	1,000,000	0
11	“S”sh.p.k.	K3	12.03.2024	12.03.2029	1,000,000	1,000,000	0
12	“F”sh.p.k.	M03	12.12.2020	12.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
13	“A”sh.p.k.	L23	10.11.2023	10.11.2028	1,000,000	1,000,000	0
14	“Z” sh.p.k.	L93			-	-	-
15	H.B pike gazi fundore	L53	23.09.2021	Pezulluar 15.04.2024	60,000	60,000	0
Shuma					11,060,000	9,260,000	1,800,000

Burimi: Bashkia Cërrik

Në tabelën nr. 34: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Subjekti	NIPT	Statusi
1	“G.C” sh.p.k.	K6	Nuk është pajisur me autorizim
2	“F” sh.p.k.	L3	Nuk është pajisur me autorizim
3	“Z.F” sh.p.k.	L9	Nuk është pajisur me autorizim

Burimi: Bashkia Cërrik

-Të ardhurat nga Asetet:

Gjatë vitit 2024 referuar të dhënave të planifikimit të të ardhurave nga asetet e Bashkisë Cërrik kemi planifikimin si mëposhtë:

Në tabelën nr. 35: Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Plani 2024	Fakti 2024 Total	% e realizimit/plan
1	Qira toke	9,000	5,920	65.77

2	Qira fondi pyjor,kullusor	8,490	4,988	58.75
3	Qira ndërtese	810	696	85.93
Total		18,300	11,604	

Burimi: Bashkia Cërrik

Nga auditimi i kontratave të qirasë për vitin 2024 rezulton se Nj.Ad Mollas është njësia që disponon më shumë kontrata të lidhura të cilat janë lidhur para vitit 2015 në ish-komunën Mollas. Në fund në vitit 2024 në këtë Nj.Administrative rezultojnë 431 kontrata aktive.

Nga këto kontrata 273 janë aktive të cilat ju ngarkohet detyrimi referuar kontratës dhe paguajnë rregullisht. Për 158 kontrata nuk janë ngarkuar detyrimet prej vitit 2017 për shkak sepse është paraqitur kërkesës nga abonentë për zgjidhjen e kontratës por nuk është konkluduar më tej. Kontrata për të cilat nuk janë ngarkuar me detyrim janë paraqitur **në aneksin nr.2/2/6/4** në anekset e raportit të auditimit.

Për 66 kontrata nga 158 kontrata total nuk janë debitore për këto kontrata nga Kryetari i Bashkisë Cërrik duhet të ngrihet një grup pune për të vlerësuar gjendjen e parcelës dhe kulturën bujqësore të mbjellë dhe më pas të procedohet më prishjen e kontratës për shkak së nga personat qiramarrës është shprehur vullneti me anë të kërkesës më shkrim për prishjen e kontratës.

Për 92 kontrata qirajë me vlerë detyrimi 14,323,599 lekë nga Bashkia Cërrik të ngrihet një grup pune për të vlerësuar gjendjen e parcelës. Të përgatitet seti i dokumentacionit dhe detyrimi sipas çdo kontrate të kërkohet në rrugë gjyqësore.

Në tabelën nr. 36:Informacion për debitorët nga kontratat e qirave për tokat bujqësore.

Njesitë Administrative	Nr.qira totale 2023	Debia Totale 31.12.2022	Debia Totale 31.12.2023	Nr.qira debitore deri më 31.12.2024	Debia Totale 31.12.2024
Njesia Shalës	125	173,688	173,688	30	324,820
Njesia Cërrik	5	126,352	96,350	1	1
Njesia Mollas	431	15,423,792	15,531,997	158	14,583,596
Njesia Gostime	0	0	0	0	0
Njesia Klos	43	7,500	14,155	5	20,990
Qirat e fondit pyjor	96	16,500	166,500	5	818,500
Qirat e Objekte	0	0	0	2	33,900
Shuma	700	15,747,832	15,982,690	201	15,781,807

Burimi: Bashkia Cërrik

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. K. B. me detyrë Përgjegjës i Taksave dhe Tarifave Vendore;
2. Znj. E. D. me detyrë Përgjegjës Sektori.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.”

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2024).
- Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2024.

- Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2024.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2024.
- Akt-rakordimet e kryera me degën e thesarit Cërrik për periudhën raportuese të vitit 2024.
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2024 Bashkia Cërrik ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihen vetëm aparati i Bashkisë Cërrik sepse Bashkia Cërrik nuk ka njësi shpenzuese të tjera. Bashkia Cërrik për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Elbasan si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Cërrik për vitin 2024 janë të nënshkruara nga z. A. S. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. H. K. me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Elbasan në datë 28.03.2025, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave.

Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimet, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Cërrik për aktivitetin ekonomik- financiar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Cërrik në 31.12.2024, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=3,048,848,651 lekë.**

- Aktivet 2,266,116,587 lekë
 - Detyrimet 314,740,027 lekë
 - Aktivet Neto 1,951,376,560 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **371,367,612 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 51,750,299 lekë;
 - Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 23,407,433 lekë;
 - Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 296,209,880 lekë;

Fondi i Konsoliduar:

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF37: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	212,390,000	1,733,392,094	Çelje
Amortizim i vitit	212,767,802	186,438,346	Investime + Dhurime
		3,970,724	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	425,157,802	1,923,801,164	Shuma
Shuma		1,498,643,362	

Burimi:Bashkia Cërrik

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 “Teprica” është kontabilizuar për vlerën 1,419,646,775 lekë.

Sipas tabelës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc është nënvlerësuar për vlerën 78,996,587 lekë.

Pasqyra PF38: Detajet e nënrubrikës “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
531	Mjete Monetare në arkë			
512	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	51,750,299	55,705,879	(3,955,580)
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera			
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë			
	Totali	51,750,299	55,705,879	(3,955,580)

Burimi: Bashkia Cërrik

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 51,750,299 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 33,220,153 lekë gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 18,530,146 lekë, gjendja e llogarisë 12 ‘Rezultatet e mbartura’ në shumën 25,050 lekë dhe gjendja e llogarisë 116 “Të ardhura nga shitja e aktiveve të qendrueshme”.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 41,439,132 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" 466 "Mjete në ruajtje, 12 ‘Rezultatet e mbartura’ dhe 116 “Të ardhura nga shitja e aktiveve të qendrueshme”.

Fondet e papërdorura për vitin 2024 janë si më poshtë:

1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2024 e papërdorur 17,350,776 lekë.

2-Të ardhurat të papërdorura 15,869,377 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 33,220,153 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2025.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”:

Pasqyra PF39: Detajet e nënrubrikës “Gjendje inventari qarkullues”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
31	Materiale	2,905,853	2,462,338	443,515
32	Inventar i imët	20,501,580	16,974,371	3,527,209
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarëve			
	Totali	23,407,433	19,436,709	3,970,724

Burimi: Bashkia Cërrik

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Cërrik në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 19,436,709 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,462,338 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët ” në vlerën 16,974,71 lekë.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Cërrik në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 23,407,433 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,905,853 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët ” në vlerën 20,501,580 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-3,970,724 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën -3,970,724 lekë

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 2,905,853 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF40: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 312 “Materiale”:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	2,462,338
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	21,258,244
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	20,814,729
Gjendja në 31.12.2024	2,905,853

Burimi:Bashkia Cërrik

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 20,501,580 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF41: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 327 “Inventar i imët”:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	16,974,371
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	3,875,301
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	348,092
Gjendja në 31.12.2024	20,501,580

Burimi:Bashkia Cërrik

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*". Titullari i Bashkisë Cërrik ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2024, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*” nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.71 datë 21.10.2024 për ngritjen e komisionit të inventarizimit. Sipas urdhrin të mësipërm inventari i aktiveve do të zhvillohet deri në 31.12.2024.

Urdhëri nr. 71 date 21.10.2024 per ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve për vitin 2024 të Bashkisë Cërrik.

Komisioni i inventarizimit ka në përbërje:

- 1-V.H.
- 2-F.A.
- 3-O.M.
- 4-T.B.
- 5-E.K.
- 6-V.M.
- 7-A.H.

Komisioni për vlerësimin ka në përbërje:

- 1- H.K. Kryetar

- 2- E.T. Antar
- 3- S.F. Antar
- 4- D.L. Antar
- 5-S.Sh. Antar

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi sipas relacionit të mbajtur ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit kontabël të hartuara nga financa.

Nga Inventarizim rezulton se gjendja kontabel e llogarisë 218 është 84,954,514 lekë. Janë vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit materialet objekt inventari të cilat kanë humbur funksionin dhe kanë mbushur afatet e normuara sipas percaktimeve të paragrafeve, 107,108,109 të udhëzimit nr.30, datë 27/12/2011 të Ministrisë së Financave objekte inventari në shumën 987,225 lekë ,si pasojë llogaria 218 është me gjendje në vlerën 83,967,289 lekë e barabarte me vlerën kontabël në bilanc .

Pasqyra PF42:Përmbledhëse e inventarit llogaria 218

Nr	Emërtimi	Cmimi	Sipas te dhenave Kontabel (sasia)	Vlera	Sipas te dhenave Inventarizimit	Vlera	Mungesat Sasi	Vlera	Propozohen jasht/përdorimit (Sasia)	Vlera
1	Cërrik	39,480,159	1	40,480,159	1	40,181,324			1	298,835
2	NJ.A Gostime	15,425,678	1	16,425,677	1	16,425,678				
3	Uji	1,166,108	1	1,166,108	1	1,166,108				
4	NJ.A Mollas	13,230,915	1	15,230,915	1	14,994,305			1	236,610
5	NJ.A Klos	4,662,469	1	4,662,468	1	4,251,689			1	410,780
6	NJA Shalës	5,751,969	1	6,128,560	1	6,087,560			1	4,1000
7	Magazina	860,624	1	860,624	1	860,624.76				0
	Shuma			84,954,514		83,967,289				987,225

Burimi:Bashkia Cërrik

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi sipas relacionit të mbajtur ka verifikuar se gjendja fizike e inventarëve sipas fletëve të inventarizimit kontabël të hartuara nga financa.

Nga Inventarizim rezulton se gjendja kontabel e llogaris 327 eshte 20,849,673 lekë. Janë vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit , materialet objekt inventari të cilat kanë humbur funksionin dhe kanë mbushur afatet e normuara sipas percaktimeve të paragrafeve, 107,108,109 të udhëzimit nr.30,datë 27/12/2011 të Ministrisë së Financave ,inventor i imët ne shumen 348,093 lekë ,si pasojë llogaria 327 eshte me gjendje ne vleren 20,501,580 lekë e barabarte me vlerën kontabël paraqitur në llogarin 32 të klases 3 të bilancit.

Pasqyra PF43:Përmbledhëse e inventarit llogaria 327

Nr	Emërtimi	Cmimi	Sipas te dhenave Kontabel (sasia)	Vlera	Sipas te dhenave Inventarizimit	Vlera	Propozohen jasht/përdorimit (Sasia)	Vlefte
1	Administrata Cërrik	8,980,513	1	8,980,513	1	8,634,001	1	346,512
2	NJ.A Gostime	6,678,156	1	6,678,156	1	6,678,156		
3	Uji	2,400	1	2,400	1	2,400		
4	NJ.A Mollas	2,029,095	1	2,029,095	1	2,029,095		
5	NJ.A Klos	529,822	1	529,822	1	528,240	1	1,581
6	NJ.A Shalës	2,174,592	1	2,174,592	1	2,174,592		
7	Magazinë	455,096	1	455,096	1	455,096		
	Shuma			20,849,673		20,501,580		348,093

Burimi:Bashkia Cërrik

Relacioni i drejtuar Titullarit të Institucionit është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit.

Mbi bazen e ketij relacioni eshte pregatitur Projekt-Vendimi dhe është miratuar nga Keshilli Bashkiak vendimi nr.29,datë 29/04/2025, “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve që kanë plotësuar afatin e përdorimit dhe kanë humbur çdo funksion” ky Vendim është konfirmuar me aktin nr.549/1,date 13/05/2025 të Prefektit të Qarkut Elbasan.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:

Pasqyra PF44: Detajet e nënrubrikës “Llogari të arkëtueshme”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme	153,443,847	151,638,448	1,805,399
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			
44	Institucione te tjera publike			
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	609,720	414,350	195,370
468	Debitorë te ndryshëm	111,765,620	119,911,530	(8,145,910)
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	41,068,507	31,312,580	9,755,927
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)			
	Totali			
	Të tjera aktive afatshkurtra	142,766,033	167,506,789	(24,740,756)
409	Furnitore(Debitorë).parapagime pagesa pjesore			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	142,766,033	167,506,789	(24,740,756)
	Totali	296,209,880	319,145,237	(22,935,357)

Burimi:Bashkia Cërrik

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 119,911,530 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 111,765,620 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur zbritje neto me vlerë 8,145,910 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, .Nga analiza e llogarisë 468 “**Debitorë të ndryshëm**” kemi detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF45: Detajet e llogarisë 468 “**Debitorë të ndryshëm**”.

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2023	Shtesa viti 2024	Pakësim viti 2024	Detyrim datë 31.12.2024
Detyrime Familjarë, Biznesi	67,624,273	11,238,257	-	78,862,530
Detyrime nga Drejtoria e Investimeve legalizimet	19,692,157	990,735	-	20,682,892
Detyrime Drejtoria Urbanistikës (zhdëmtime klsh)	17,275,100	-	5,549,902	11,725,198
Gjoba IMTV	15,320,000	-	14,825,000	495,000
Shuma	119,911,530	12,228,992	20,374,902	111,765,620

Burimi: Bashkia Cërrik

Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme:

-Detyrimet progresive të kontabilizuara për gjobat e IMTV janë në vlerën 495,000 lekë. Këto detyrime janë kontabilizuar në këtë llogari pa shkresë përcjellëse nga sektori i IMTV por vetëm sipas procesverbaleve të mbajtur nga inspektorët. Në fillim të vitit 2024 detyrimi për gjobat nga

IMTV ka qënë në vlerën 15,320,000 lekë, kjo llogari në muajn dhjetor 2024 është pakësuar për vlerën 14,825,000 lekë referuar ligjit për faljen e gjobave.

-Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për abonentë familjarët dhe biznes në datën 31.12.2023 janë kontabilizuar në vlerën 67,624,273 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në fund të vitit 2024 ka paraqitur informacion në Drejtorinë e Financës për gjendjen e debitorëve progresivë në fund të vitit 2024.

Llogaria 468 sipas udhëzimit nr. 5 ,datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” citohet.

-Për Konstatimin paraprak të të drejtave për tu arkëtuar debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje”.

-Për arkëtimin e të drejtave, në të njëjtën kohë më veprimin e mësipërm kryhet veprimi i kundërt, debitohet llogaria 470 dhe kreditohet llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë (411/468).

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 41,068,507 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 41,068,507 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF46: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	2024	2023
Llogari 401-408	152,189,711	171,301,002
Paga personeli llog 42	24,957,934	24,422,793
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	1,185,575	561,083
Sigurime shoqërore llog.435	4,834,707	2,276,479
Sigurime shëndetësore llog.436	666,613	258,000
Kreditor të ndryshëm llog.467	112,375,340	120,325,880
Totali pa përfshirë llogarinë 467	183,834,540	198,819,357

Burimi:Bashkia Cërrik

Referuar udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” citohet.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” (detyrime).

Kjo është një llogari që në pasqyrat financiare të NJQP paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzimet/shërbimet e kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin” është kontabilizuar në kundërshtim me udhëzimin nr.5 si mësipër.

Referuar të dhënave të tabelës PF46 mësipër llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të kontabilizohet për vlerën 183,834,540 lekë. Kjo llogari është kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 41,068,507 lekë e cila është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 142,766,033 lekë.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 142,766,033 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 167,506,789 lekë.

Referuar udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

42. Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre:

- “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore”
- “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime”
- “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje”;
- “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime”;
- “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura të tjera”.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe
- Kreditohet llogaria përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh. qera të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë dhe të tjera.

Referuar ndryshimeve sipas udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Seksioni 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithme”, paragrafi 42 ndryshon si vijon:

Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin llogaritë kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me keto të fundit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31.12.2021.

Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 43,082,009 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 33,539,667 lekë, shtesa gjatë vitit 2024 në vlerën 4,484,659 lekë, amortizim i vitit 2024 në vlerën

24,801,710 lekë dhe vlerë neto në vlerën 4,401,247 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” gjatë vitit 2024 janë kontabilizuar në këtë llogari 11 projekte me kosto historike 15,708,644 lekë amortizim i akumuluar 11,307,397 lekë dhe vlerë kontabël neto 4,401,247 lekë. Për këto projekte procedurat e prokurimit janë kryer gjatë vitit 2017-2024.

Pasqyra PF47: Lista e projekteve të kontabilizuara në llogarinë 202

Nr	Emri i Projektit	Viti i rregjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera neto	kontabel
1	Projekt rikualifikim Urban	2020	274,678	164,806		109,872
2	Projekt Ujesjelles Klos	2019	3,414,000	2,560,400		853,600
3	Projekt. I Rikonst e Sistem. asfaltimit	2017	3,883,341	3,494,007		389,334
4	Oponenc teknike Ujsjellesi Klos	2019	4,784,461	3,588,125		1,196,336
5	Projekt rikualifikim urban	2019	407,505	305,060		102,445
6	Projekt kanale ujitës	2020	894,000	536,400		35,7600
7	Apartamente	2020	780,000	468,000		312,000
8	Projekt Reabilitim Kanale Ujitëse	2024	114,000	17,100		96,900
9	Projekt elektrik	2024	118,800	17,820		100,980
10	Plan pjesshem vendor	2024	218,440	32,766		185,674
11	Projekt varreza	2024	819,419	122,913		696,506
Shuma			15,708,644	11,307,397		4,401,247

Burimi: Bashkia Cërrik

Pasqyra PF48: Projektet e kontabilizuara në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” për vitin 2024.

Nr	Emërtimi	Shtesa 2024
1	Projekt Ujesjelles Klos	914,000
2	Projekt. I Rikonst e Sistem. asfaltimit	2,300,000
3	Projekt Reabilitim Kanale Uitse	114,000
4	Projekt elektrik	118,800
5	Plan pjesshem vendor	218,440
6	Projekt varreza	819,419
Shuma		4,484,659

Burimi: Bashkia Cërrik

Referuar udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” citohet.

Aktivet afatgjata jomateriale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, market, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit tj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM ashtu edhe të AAGJ/JM në këto raste ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Projektet janë pjesë përbërëse e investimeve publike që kryhen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në këtë rast projekti do të duhet të kontabilizohet në llogaritë përkatëse të aktivitetit në momentin e marrjes në dorëzim të aktivitetit të investuar sepse projekti është pjesë përbërëse e këtij aktiviteti. Vlera e projekteve të kontabilizuara në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” me kosto historike 15,708,644 lekë dhe VKN në shumën 4,401,247 lekë duhet të kontabilizohet në llogaritë përkatëse për aktivitetet e investuara. Për projektet të cilat nuk janë kryer investimet ose nuk janë marrë në dorëzim do të duhet të jenë të kontabilizuara në llogarinë 230 “Investime”.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024, paraqiten në shumën 1,391,467,815 lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,625,046,197 lekë. Gjatë viti 2024 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 119,981,377 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 30,114,286 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 31,858,024 lekë. Pakësimet nga amortizimit

gjatë vitit 2024 kanë qenë në vlerën 177,420,663 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 382,754,370 lekë.

Pasqyra PF49: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale” viti 2024.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2023	Shtesa 2024	Amortizim 2024	Pakësime neto 2024	Gjendja me 31.12.2024
210	Toka, Troje, Terrene	43,500,252	0	0	0	43,500,252
211	Pyje, Kullota, Plantacione	11,169,913	600,000	0	0	11,769,913
212	Ndërtime e Konstruksione	794,323,290	70,326,593	42,487,010	0	822,162,873
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	703,280,674	75,747,492	157,353,766	205,178,713	416,495,687
214	Instalime dhe paisje	46,763,416	4,404,572	2,539,231	0	48,628,757
215	Mjete Transporti	10,998,843	22,223,000	3,978,169	0	29,243,674
218	Inventar Ekonomik	15,009,809	8,652,030	3,840,186	154,994	19,666,659
	Shuma	1,625,046,197	181,953,687	210,198,362	205,333,707	1,391,467,815

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene” është paraqitur në bilanc në vlerën 43,500,252 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2024 dhe është regjistruar në bilanc në vlerën 43,500,252 lekë.

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Ky veprim është në kundërshtim Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është paraqitur në bilanc në vlerën 11,169,913 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 600,000 lekë projekt i transferuar nga llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”.

Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 11,769,913 lekë.

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik.. Ky veprim është në kundërshtim Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga auditimi i llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”. Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 794,323,290 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 48,279,208 lekë shtesa pa pagesë në vlerën 12,106,376 lekë. Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 42,487,010 lekë. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 822,162,873 lekë.

Kapitalizimi për vitin 2024 është në vlerën 70,326,593 lekë për objektet si mëposhtë:

1. Rikualifikim urban dhe kende lojrash në vlerën 5,372,621 lekë.
2. Përmirësimi i kushteve të banimit 14,764,104 lekë.
3. Kolaudim banesa 556,017 lekë.
4. Përmirësimi i kushteve të banimit 27,586,466 lekë.
5. Qendër shëndetësore 12,106,36 lekë.
6. Shtesa nga projektet e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” 9,941,009 lekë.

Kapitalizimi për vitin 2024 në vlerën 39,521,259 lekë për objektet si më poshtë:

1- Përmirësim i banesave sociale 11,934,793 lekë

2- Përmirësim i banesave sociale 27,586,466 lekë

Për kontabilizimin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” të aktivitetit të mësipërm është vepruar në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale” pika 8. *Njësia ekonomike njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) aktiviteti kontrollohet nga njësia ekonomike; (b) është e mundur që nga përdorimi i aktivitetit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitimë të ardhshme ekonomike; (c) kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.*

4. Llogaria 213 “ Rrugë,rrjete,vepra ujore”

Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 03,280,674 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 75,747,492 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve 20,700,010 lekë. Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 157,353,766 lekë. Me VKB nr.91, datë 27.12.2023 “Për transferim kapital të aseteve të Bashkisë Cërrik” dhe në bazë të vendimit nr.302, datë 11.05.2023 “Për politikën kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotuar” u miratua kalimi i kapitalit pa pagesë nga Bashkia Cërrik tek Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan objektet si mëposhtë:

1. Rjeti i linjave KUZ, të Bashkisë Cërrik me kosto historike	171,301,008 lekë
➤ Me vlerë neto	54,176,546 lekë
➤ Amortizim i akumuluar	117,124,462 lekë

Pasqyra PF50: Rrjeti i linjave KUZ i transferuar.

Nr	Konstruksione te veprave ujore	A.Akumuluar	Vlera Neto
1	Kuz lagjen nr.1	13,712,080	6,340,684
2	Kuz lagjen nr.2	19,445,038	8,991,695
3	Kuz lagjen nr.3	10,030,764	4,638,385
4	Kuz kolektori kryesor	19,082,322	8,823,970
5	KUZ Linje kryesore lagje 2	12,800,599	5,919,201
6	Kuz lagjia 1,2,3	25,032,755	11,591,875
7	Kuz Cërrik (Linja e Stadiumit)	17,020,903	7,870,737
Total		117,124,462	54,176,546

Burimi: Bashkia Cërrik

2. Rjeti i Ujësjetllës të Bashkisë Cërrik me kosto historike	387,054,468 lekë
➤ Me vlerë neto	122,411,886 lekë
➤ Amortizim i akumuluar	264,642,682 lekë

Pasqyra PF51: Rrjeti i linjave KUZ i transferuar.

Nr	Konstruksione te veprave ujore	A.Akumuluar	Vlera Neto
1	Rikonstruksion ujesjetllës faza pare pomp-depo	16,408,800	7591200
2	Rikonstruksion ujesjetllës lagjia nr.1	25,456,729	11,771,596
3	Rikonstruksion ujesjetllës lagjia nr.2	32,406,657	14,985,353
4	Rikonstruksion ujesjetllës lagjia nr.3	28,470,588	13,165,253
5	Rikonstruksion ujesjetllës Faza 3	74,438,845	34,389,876
6	Ujesjetllës Banje -Trunc	5,588,824	2,584,361
7	Ujesjetllës Shtermen	10,098,358	4,669,641
8	Ujesjetllës Gostim	11,532,560	5,332,839
9	Ujesjetllës Shtepanje	5,380,207	2,485,592
10	Depo Uji Malasenje	6,745,687	3,119,313
11	Depo Uji Gostim	8,653,933	3,999,866
12	Ujesjetllës Gjyral	8,546,580	4,021,920
13	Ujesjetllës Xherije	24,437	11,300
14	Ujesjetllës Shushicë	34,190	15,810
15	Ujesjetllës(depo) Xherije-Kodras	5,695,939	2,633,892
16	Ujesjetllës Cërrik-Ferme -Xibr	23,548,831	10,888,880

17	Ujesjelles Selit	1,611,511	745,188
Totali		264,642,681	122,411,886

Burimi: Bashkia Cërrrik

Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 416,495,687 lekë.

Kapitalizimi për vitin 2024 është në vlerën 75,747,492 lekë për objektet si mëposhtë:

1. KUZ në vlerën 55,780 lekë.
2. Supervizim Rruga Linas në vlerën 978,200 lekë.
3. Supervizim Rruga rurale në vlerën 1,319,507 lekë.
4. Kolaudim rrugë rurale në vlerën 1,878,383 lekë.
5. Rikonstruksion rrugë Qyrkan në vlerën 26,092,473 lekë.
6. Rikonstruksion rrugë lagja nr.3 në vlerën 2,618,598 lekë.
7. Rikonstruksion rrugë e Lushallijve në vlerën 21,037,789 lekë.
8. Rikonstruksion rrugë e Dyrmave në vlerën 1,066,752 lekë.
9. Shtesa nga projektet e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” 20,700,010 lekë.

Kapitalizimi i investimeve në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është kontabilizuar në përputhje me udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”. Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë .Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë neto kontabël 48,628,757 lekë.

Bashkia gjatë vitit 2024 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 3,787,567 lekë. Blerje pa pagesë gjatë vitit 2024 janë në vlerën 0 lekë. Levizje brenda aktiveve me vlerë prej 617,005 lekë të cilat janë projekte .

Pasqyra PF52: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	3,787,567	-	-	617,005
Total		3,787,567	-	-	617,005

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF53: Detajet e nënrubrikës “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.histoike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
72,046,780	25,283,364	46,763,416	4,404,572	2,539,231	0	0	76,451,352	27,822,595	48,628,757

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

6. Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Cërrrik.

Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 10,998,843 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 8,892,000 lekë

shtesa pa pagesë në vlerën 13,331,000 lekë. Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 3,978,169 lekë. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 29,243,674lekë.

Pasqyra PF54: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 215 “Mjete Transporti”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	8,892,000	13,331,000	-	-
Total		8,892,000	13,331,000	-	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF55: Detajet e nënrubrikës “Mjete Transporti”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
57,832,895	46,834,052	10,998,843	22,223,000	3,978,169	-	-	80,055,895	50,812,221	29,243,674

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Lista e mjeteve në posedim të Bashkisë Cërrik është pasqyruar në aneksin nr.2/3/1 në anekset e raportit të auditimit.

6. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Cërrik. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Cërrik gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 15,009,809 lekë. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është pakësuar me vlerën 4,656,850 lekë.

Pasqyra PF56: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Bashkia	3,975,120	4,460,910	216,000	-
Total		3,975,120	4,460,910	216,000	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF57: Detajet e nënrubrikës “Inventar ekonomik”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
76,302,484	61,292,675	15,009,809	8,652,030	3,840,186	987,225	832,231	83,967,289	64,300,630	19,666,659

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Cërrik në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 1,587,479,658 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2024. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2024.

Në aneksin nr 2/3/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur amortizimi i AAGJ.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Cërrik, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund 2024 në vlerën 320,000 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2024 është paraqitur në vlerën 320,000 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

-Bashkia Cërrik , në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 8% të aksioneve të “E” SH.A me NUIS “M1” e cila është shoqëri aksionere me objekt *“Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike të ngurta të gjelbërta”*. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 3,500,000 lekë nga këto Bashkisë Cërrik i përkasin 8% të aksioneve me vlerë monetare 280,000 lekë.

-Bashkia Cërrik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 5.46 % të aksioneve të “Sh. R. U. K. E.” sh.a me NUIS “M2” e cila është shoqëri aksionere me objekt, *“Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”*.

Numri i aksioneve është 5,460 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 546,000 lekë.

-Bashkia Cërrik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 40 % të aksioneve të “K. F. T.” sh.a me NUIS“K7” e cila është shoqëri aksionere me objekt, *“Zhvillimin e sportit të futbollit nëpërmjet krijimit të një ekipi për të rritur”*. Shoqëria është krijuar me kapital aksionar në vlerën 100,000 lekë nga këto 40,000 lekë është kapital i Bashkisë Cërrik.

Vlerat e “Sh.R.U.K. E.” sh.a sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2024 , më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesmarrje”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 540,600 lekë dhe investori është Bashkia Cërrik.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivët Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne Pjesmarrje me vlerë kontabël 540,600 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

4. Investimet:

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2024 paraqitet në vlerën 498,559,913 lekë Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 498,559,913 lekë, përkatësisht 1,449,960 lekë në llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 497,109,953 lekë në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Referuar udhëzimit udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” këto llogari

paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”.

Në **aneksin nr.2/3/3** në anekset e raportit të auditimit paraqiten lista e investimeve në proces e rakorduar me degën e thesarit Elbasan.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Cërrrik më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF58: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

Llogaritë		Viti 2024	Viti 2023
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	152,189,711	171,301,002
42	Detyrime ndaj personelit	24,957,934	24,422,793
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,185,575	561,083
435	Sigurime shoqërore	4,834,707	2,276,479
436	Sigurime shëndetësore	666,613	258,000
467	Kreditor të ndryshëm	112,375,340	120,325,880
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	0	0

Burimi:Bashkia Cërrrik

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2024 është në vlerën 152,189,711 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Cërrrik më 31.12.2024. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në **aneksin nr. 2/2/4** në anekset e raportit të auditimit.

Referuar shkresës nr. 437 prot., datë 09/02/2024 “Raport vjetor i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare për periudhën janar-dhjetor 2023, Bashkia Cërrrik” të dërguar në MF dhe sipas publikimit në faqen e saj detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2023 paraqiten në shumën 135,064,466 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2024 detyrimet e prapambetura të raportuara me shkresën nr.prot. 641 prot., datë 28/02/2025 dhe të publikuara në faqen e MF paraqiten në shumën 115,953,175 lekë. Gjatë vitit 2024 janë krijuar 29,171,309 lekë detyrime dhe është likuiduar vlera 48,282,600 lekë. Vlera e detyrimit të mbetur të palikuiduar në fund të vitit 2024 është 152,189,711 lekë e ndarë:

- Detyrime te ministrive të linjës 26 në shumën 36,236,536 lekë
- Detyrime Bashkia Cërrrik 115,953,175 lekë

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Cërrrik, paraqitet në vlerën 24,957,934 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe jane paguar ne muajin janar 2024 në shumen 24,957,934 lekë.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,185,575 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne Janar 2024.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 4,834,707 lekë.

Llogaria 436, “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetsore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 666,613 lekë.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Cërrrik, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 18,530,146 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Në aneksin nr 2/3/4 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur informacioni analitik për llogarinë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 836,617,168 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 96,478 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 35,352,752 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 38,855,511 lekë.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 42,187,459 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 11,798,927 lekë, e cila përfshin, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 30,519,300 lekë, e cila përfshin etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 803,472,345 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 204,271,633 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 204,271,633 lekë.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 38,351,928 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 38,351,928 lekë.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 135,123,618 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 135,123,618 lekë.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 400,133,216 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2024 totali i te ardhurave ne vlere është 836,617,168 lekë dhe totali shpenzimeve është 803,472,345 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 33,144,822 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. H. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Burimeve Njerëzore

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a), (b) dhe (c) të nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 31/8 prot. datë 15.05.2024 i ka dërguar Bashkisë Cërrik, “Raportin përfundimtar”, për përmirësimin e gjendjes, si dhe ka rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Cërrik nuk ka respektuar këtë afat, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr.1607/1 Prot., datë 01.08.2024, bashkëlidhur Urdhrin nr.212, datë 11.07.2024 mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masat për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, duke kthyer përgjigje me anë të shkresës me Nr. 381/1 Prot., datë 13.02.2025, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 190/7 prot., datë 02.07.2024, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 14 masa organizative;

b. Janë rekomanduar 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 554,100 lekë;

c. Janë rekomanduar 3 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;

d. Janë rekomanduar 1 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;

e. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Cërrik që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 5 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 190/7 Prot., datë 02.07.2024, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Cërrik)	Pa pranuar
1	Organizative	14 masa	14 masa	-
2	Shpërblim dëmi	5 masa	5 masa	-
3	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	3 masa	3 masa	-
4	Për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit	1 masa	1 masa	-
5	Masa Disiplinore	5 masa	5 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1.	Organizative	13 masa	2 masa	1 masa	7 masë	3 masa
2.	Shpërblim dëmi	5 masa	-	-	5 masa	-
3.	Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	2 masa	1 masë	-	1 masë	-
4.	Për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit	1 masë	-	-	-	1 masë
5.	Masa Disiplinore	5 masa	5 masa	-	-	-

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

-Janë lënë 14 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, është zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatimi 7 masa , zbatuar 2 masa dhe pa zbatuar 3 masa. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohen 4 masa organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 701,585 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e pranuar, 5 masa janë në proces zbatimi.

- Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë rekomanduar 2 masa, nga të cilat rezultojnë 1 masë zbatuar plotësisht dhe 1 masë në proces zbatimi.

- Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara është rekomanduar 1 masë, e cila nuk është zbatuar.

- Janë rekomanduar 5 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet si më poshtë:

Sipas “Ligjit për Nëpunësin Civil” i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Cërrik që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 5 punonjës.

Nga verifikimi rezultojnë se me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 293 dt 26.09.2024 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në Bashkinë Cërrik”, është ngritur Komisioni Disiplinor. Data e

zhvillimit të seances dëgjimore 16.10.2024. komisioni disiplinor nuk ka marre vendim për masë disiplinore.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

“Mjedisin e kontrollit”:

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese.

- Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar; Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe nuk ka marrë vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut; Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

“Menaxhimi e Riskut”.

- Bashkia Cërrik nuk ka hartuar një strategji plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

- Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, ku të përcaktohen nivelet e tolerancës së riskut.

“Aktivitetet e Kontrollit”.

Titullari i Bashkisë Cërrik për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, si dhe nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

“Informimin dhe komunikimin”.

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj, pasi mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të MFK, si dhe mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK.

“Monitorimi”.

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti, e cila lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

- Auditimi i brendshëm si pjesë e monitorimit të zbatimit të sistemeve të MFK në të gjitha njësitë dhe strukturat, nuk ka kryer mjaftueshëm funksionin e saj.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, Kreu II, neni 8/a, neni 10,16, Kreu III, neni 20,21/2,24/1, me *“Manualin për MFK”* i miratuar me Urdhër të MF nr. 108, datë 17.11.2016, Kap. III, pikat 3.1,3.2,3.3, 3.5, Kap. IV, Kap. V, Anekset, me Udhëzimin e MF nr.16, datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*, pika 3.2.1,4,5.2.7.

1.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrik, të marrin masa për: (i) Hartimin e një plan veprimi për menaxhimin financiar, hartimin e një strategjie të plotë të riskut, dhe hartimin e procedurave për mashtimin. (ii) Të sigurojë raporte periodike mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm shoqëruar me një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. (iii) Të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit për çdo proces pune, të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e GMS dhe EMP, si dhe të dokumentohet puna e tyre. (iv) Të përcaktohen rregullave të monitorimit dhe plan veprimi për ecurinë e sistemit të MFK dhe në bazë të saj të sigurohet informim dhe raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar programit të auditimit nr. 408/1 prot, datë 08.04.2025, i ndryshuar “ Për auditimin financiar dhe të përpuethshmërisë në Bashkinë Cërrik” është auditur pika 1 e programit të auditimit “Mbi menaxhimin financiar të kontrollit të brendshëm”. Nga auditimi u konstatua se rekomandimi 1.1 është zbatuar pjesërisht. Janë hartuar disa raporte periodike për mangësitë e konstatuara në sistemin e kontrollit të brendshëm. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **në proces zbatimi**.

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2 auditues, kur duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Konstatohet se njëri nga audituesit nuk është në përputhje me kuadrin ligjorë pasi nuk ka eksperiencë të auditim dhe nuk ka kryer kurse trajtimi. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të.

Nga auditimi i 6 dosjeve të auditimit nga NJAB, Cërrik rezultoi se:

- Në Planet Strategjike mungojnë objektivat, nuk është bërë përshkrimi i numrit të subjekteve që NJAB ka detyrimin për auditim si dhe identifikimin e fushave dhe sistemeve prioritet. Ndërsa në Planin vjetor mungonin rubrikat: zhvillimet aktuale të NjAB, prioritetet e auditimit për vitin, objektivat kryesore për vitin dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë. Realizimi i planit për vitin 2023 paraqitet në masën 71%, ku për mosrealizimin e auditimeve të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi i tij nga titullari.

- Në raportimin e progresit të rekomandimeve NJAB nëpërmjet raporteve vjetore të dërguara zyrtarisht në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm është dhënë statusi i rekomandimeve, pa shpjeguar mënyrën se si u administrua dhe u përpunua informacioni, që mbështet përfundimin mbi nivelin e pranimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara në masën 100% dhe nivelit të zbatimit të tyre në masën 54% në vitin 2023, të dhëna këto që në dosjet e shqyrtuara dhe raportet e auditimeve nuk dalin të qarta këto të dhëna.

- Në të gjitha dosjet e auditimit mungon projekt drafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit me Formatet e miratuara dhe testet përkatëse; Programet e angazhimit në të gjitha rubrikat nuk është hartuar sipas Formatit 8 të miratuar. Nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të MFK:, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. Raportet nuk janë në përputhje me formatin e raportimit dhe nuk janë koncize dhe të sakta në përmbajtjen e tyre. Nuk dokumentohej procesi i ndarjes së detyrave, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës. Në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nuk janë reflektuar lidhjet organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime, pasi nuk janë të qarta dhe të sakta. Për rekomandimet e adresuara nuk është përcaktuar afati i zbatimit të tyre

si dhe nuk është përcaktuar niveli i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët); Mungon plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve. Në dosje mungon “Memo” drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet. Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e pagesave, transaksioneve financiare dhe raportimit të pasqyrave financiare etj. Mungon Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të NJAB i miratuar nga titullari dhe procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program angazhimi nuk kryhej.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11,12/d, 19 dhe 20, me MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020, Kapitulli II pika 2.4.1 dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1/11,12; kapitulli VI pika 6.1; Kapitulli VII, pika 7.1.1.

2.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Bashkinë Çërrik të marrin masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditimit me rekrutime cilësore dhe të kujdesen për certifikimin dhe trajnimin e tyre.

2.2. Rekomandimi: NJAB të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të ngrihet Komiteti i Auditimit. Të hartohen saktë dhe në mënyrë të plotë planet strategjike, raportimet e veprimtarisë, programet e angazhimeve, raportet e auditimit në të gjitha rubrikat e tyre, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e opinionit për to, si dhe formulimin e saktë të, konkret e të plotë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Në fund të auditimit të hartohen memo informuese për titullarin me konkluzionet dhe sistemet e vlerësuara me risk. Të programohet dhe të realizohet auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lënë nga auditimet e KLSH dhe NJAB, si dhe të kryhen angazhime auditimi në fushat të vlerësuara me risk. NjAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit monitorimit dhe të vetëvlerësimit periodik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me rekomandimin 2.1 nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është konstatuar se Pozicioni i Përgjegjës të Auditimit në Bashkinë Çërrik është shpallur sipas procedurave ligjore në portalin shërbimi kombëtar i punësimit (shkp), por nuk ka pasur asnjë aplikant. Në strukturën e brendshme organizative të bashkisë ky sektor rezulton me dy specialist. Vetëm njëri prej dy specialistëve është i certifikuar si Auditor.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **në proces zbatimi**.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është konstatuar se:

-Bashkia Çërrik nuk ka Komitet të Auditimit të Brendshëm në kundërshtim me legjislacionin e sipërcituar

-Ka shmangie nga Plani Vjetor i Auditimeve, të cilat nuk janë argumentuar në Raportin Vjetor dërguar MFE.

- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 dhe nenin 19 pika 1 të “Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- Nuk ka proces të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve

- Në disa prej raporteve përfundimtare të dosjeve të auditimit mungojnë disa nga formularët e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer angazhime auditimi në fushat të vlerësuara me risk me një periodicitet të lartë.

- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitet e menaxhimit

- NjAB nuk ka kryerë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit monitorimit dhe të vetëvlerësimit periodik.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohej përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar pjesërisht**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Çërrik ka diferenca me vlerën e planifikuar. Referuar treguesve të buxhetit për vitin 2023, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 489,143 mijë lekë, ndërsa realizimi 459,607 mijë lekë, ose në masën 93.96%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 181,103 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 180,607 mijë lekë, ose në masën 99.72%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 97.54%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 146,531 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 127,207 mijë lekë, ose në masën 86,8%. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 33-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Çërrik, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi realizimet faktike të viteve ushtrimore dhe në parashikime. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2024, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 504,005 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 573,872 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 507,376 mijë lekë ose në masën 88%.

Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 238,772 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 232,876 mijë lekë ose në masën 97%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 123,468 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 123,206 mijë lekë ose në masën 99%.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 22,362 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 14,768 mijë lekë ose në masën 66 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230*231) është planifikuar në vlerën 145,819 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 136,526 mijë lekë ose në masën 93%.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në **proces zbatimi**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ku t'i referohet kërkesave reale të institucionit pasi:

- Nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

- Në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 33-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që:

- Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

- Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 172,883 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 139,607 mijë lekë ose në masën 80.75% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 37,117 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në **proces zbatimi**.

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto prej 9,542,342 lekë dhe me kosto historike në vlerën 43,082,009 lekë. Referuar analizës së gjendjes në vlerë bruto prej 43,082,009 lekë i përket 48 projekteve, të cilat janë:

- 11 projekte në vlerën bruto prej 7,627,769 lekë nuk janë zbatuar në mungesë të kryerjes së investimit.

- 24 projekte në vlerën bruto 31,241,880 lekë, ku sipas informacionit të Drejtorisë së Financës dhe Pronave investimet në zbatim të tyre janë në proces, për të cilat nuk ka një analizë të qartë të tyre nëse aktivet, të cilat u përkasin këtyre projekt-studimeve janë kapitalizuar apo jo për të vazhduar më tej me bashkimin e vlerës projektit me vlerën e aktiveve përkatëse që janë kapitalizuar.

- 12 projekte në vlerën bruto prej 4,212,360 lekë pretendohet se janë amortizuar, por në fakt amortizimi është përlogaritur për çdo vit në grup aktivesh dhe jo aktiv për çdo aktiv, duke sjelle mungesë të dhënash, nëse është amortizuar në vlerë të plotë apo pjesor dhe në çfarë vlere të mbetur është çdo aktiv pjesë e gjendjes së llog. 202 “*Studime dhe kërkime*” në vlerë neto 9,542,342 lekë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu II “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 16/b.d, Kreu III. Aneksi 1, pika 2, Klasa 2.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike për vlerat e projekteve gjendje të llog. 202 “*Studime dhe kërkime*”, të kryejë analizën e projekteve sipas investimeve nëpërmjet të shqyrtimit të dokumentacionit financiar dhe tekniko-ligjor të tyre, llogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktiv i afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi i llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” gjatë vitit 2024 janë kontabilizuar në këtë llogari 4 projekte me kosto historike 4,484,659 lekë.

Vlera e projekteve e kontabilizuar në llogarinë 202 “*Studime dhe Kërkime*” VKN në shumën 4,401,247 lekë duhet të kontabilizohet në llogaritë përkatëse për aktivet e investuara. Për projektet të cilat nuk janë kryer investimet ose nuk janë marrë në dorëzim do të duhet të jenë të kontabilizuara në llogarinë 230 “*Investime*”.

Gjatë vitit 2024 llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*” është pakësuar nga vlerat e projekteve si mëposhtë të cilat kanë kaluar në llogaritë 212 “*Ndërtesa*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”

Në llogarinë 212 “*Ndërtesa*” kanë kaluar projekte me vlerë 9,941,009 lekë

Në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” kanë kaluar projekte me vlerë 20,700,010 lekë

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në **proces zbatimi**.

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën neto 703,280,674 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike, në vlerën 1,841,815,935lekë. Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimin dhe përpunimin të ujërave të ndotura*” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës

Kanalizime Elbasan, Ujësjetllës Kanalizime sha Cërrik i është bashkëngjitur Ujësjetllës Kanalizime Elbasan. Këshilli i Bashkisë Cërrik me VKB nr.91, datë 27.12.2023 “Për transferimin kapital të aseteve të Bashkisë Cërrik” ka miratuar kalimin pa pagesë nga Bashkia Cërrik në Shoqërinë e Ujësjetllës kanalizimeve Elbasan objektet e mëposhtme:

1. Rrjetin e linjave KUZ të Bashkisë Cërrik, kosto historike me vlerë 171,301,008 lekë dhe me vlerë neto 54,176,546 lekë.

2. Rrjetin e ujësjetllësit të bashkisë Cërrik me kosto historike në vlerën 387,054,468 lekë dhe vlerë neto 122,411,886 lekë.

Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjetllës, që duhej të transferoheshin tek “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha, për 33 objekte në vlerën 974,489,659 lekë (përfshirë investime në ujësjetllës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji) në kundërshtim me VKM nr. 153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore, të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Cërrik dhe Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të kryejë procedurat ligjore për transferimin tek “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sha të AAGJM që i përkasin gjendjes së llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” të ish-Ujësjetllës Kanalizime Sha Cërrik, dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Me VKB nr.91, datë 27.12.2023 “Për transferim kapital të aseteve të Bashkisë Cërrik” dhe në bazë të vendimit nr.302 , datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotuar” u miratua kalimi capital pa pagese nga Bashkia Cërrik tek Shoqria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan objektet si mëposhtë:

1.Rjeti i linjave KUZ, të Bashkisë Cërrik me kosto historike	171,301,008 lekë
➤ Me vlerë neto	54,176,546 lekë
➤ Amortizim i akumuluar	117,124,462 lekë
2.Rrjeti i Ujësjetllësit të Bashkisë Cërrik me kosto historike	387,054,468 lekë
➤ Me vlerë neto	122,411,886lekë
➤ Amortizim i akumuluar	264,642,682lekë

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është zbatuar plotësisht.

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 3,211,522,798 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimin për çdo lloj grup aktivi. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 43,500,252 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 11,169,913 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,065,772,500 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,841,815,935 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 72,046,780 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë

investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Mungon regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi i klasës 2 të AFGJM, Drejtorja e Financës disponon një regjistër elektronik por nuk disponohen të gjithë të dhënat e aktive në posedim të Bashkisë Cërrik.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 79,366,846 lekë, ku nga auditimi rezultoi se, kjo gjendje paraqet pjesëmarrjen në investime kapitale të Bashkisë Cërrik nëpërmjet zotërimit të aksioneve në masën 8% në vlerën 280,000 lekë në Shoqërinë e përbashkët tregtare “Eco-Elb” Sha, në masën 100% në vlerën 79,086,846 lekë në Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime, Cërrik” Sha, por mungon pjesëmarrja në masën 40% në vlerën 100,000 lekë në Shoqërinë së përbashkët “Sport Klub Futbollit “Turbina” Sha, për të cilën duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në kredi të llogarisë 1011, “Shtesa të fondit bazë”.

- Me VKM nr. 302, datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sha, “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha, i është bashkëngjitur “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sha, si rezultat nuk janë kryer veprimet sistemuese në kontabilitet në lidhje me investimet kapitale.

- Nga Bashkia Cërrik nuk kanë filluar ende procedurat për kalimin në shitje të aksioneve në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “Turbina” Sha, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore (nenit 22 të ligjit 79/2017, datë 29.07.2020 “Për sportin” të ndryshuar me 105/2020, datë 29.07.2020). Në të dhënat e regjistrimit tregtar të Shoqërisë “Sport Klub Futbollit “Turbina” Sha, rezultoi se Bashkia Cërrik është zotëruese e 40% të aksioneve të saj. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 31. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrik të kryhen procedurat e shitjes së aksioneve të Bashkisë Cërrik në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “Turbina” Sha.

Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të kryej veprimet sistemuese kontabël për investimet kapitale në ish-Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Cërrik” Sha dhe në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “Turbina” Sha në llogaritë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” e llog. 1011, “Shtesa të fondit bazë”.

Deri me datë 31.12.2024

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 320,000 lekë.

-Bashkia Cërrik , në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 8% të aksioneve të “ECO-ELB” SH.A me NUIS“M1360604T” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi I mbetjeve të ndryshme, organike të ngurta të gjelbërta”. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 3,500,000 lekë nga këto Bashkisë Cërrik i përkasin 8% të aksioneve me vlerë monetare 280,000 lekë.

-Bashkia Cërrik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 5.46 % të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan” sh.a me NUIS “M23322201V” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 5,460 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 546,000 lekë.

-Bashkia Cërrik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 40 % të aksioneve të “Klubit Futbollit Turbina” sh.a me NUIS“K72804202B” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Zhvillimin e sportit të futbollit nëpërmjet krijimit të një ekipi për të rritur”. Shoqëria është krijuar me capital aksionar në vlerën 100,000 lekë nga këto 40,000 lekë është capital I Bashkisë Cërrik.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 540,600 lekë dhe investori është Bashkia Cërrik.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivitet Afatgjatë Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesëmarrje me vlerë kontabël 540,600 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **nuk është zbatuar**.

9. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në **32** raste faturash me vlerë 68,473,784 lekë, mbi afatin ligjor 30 ditor të pagesave nga data e faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Cërrik.

Pjesa e kësaj gjetje (9) duhet të riformulohet në funksion të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” si më poshtë:

- Gjithashtu nga auditimi rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 135,064 mijë lekë (29.4%) kurse shpenzimet vjetore faktike të vitit 2023 janë në vlerën 459,607 mijë lekë. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të pa paguara të Bashkisë Cërrik janë 29.4% të shpenzimeve vjetore faktike në muajin pasues dhe tejkalojnë 20% të shpenzimeve. Në këto kushte bashkia konsiderohet në “vështirësi financiare”, pasi vonesat në

likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues dhe tejkalojnë nivelin prej 20% dhe vlera e stokut është rritur progresivisht mbi nivelin prej 25% të shpenzimeve vjetore faktike.

Sa më lart në kundërshtim me ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55, 56 dhe Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33, (Tabela 1) Rastet sipas gjendjes financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe pikat 86-123.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: - Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike Bashkia Cërrik, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

9.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të hartojë një plan specifik zbatimi për daljen nga gjendja e vështirësisë financiare duke ja paraqitur Këshillit Bashkiak. Të marrë masat për rritjen e të ardhurave, shkurtimin e shpenzimeve dhe mundësitë potenciale të aseteve në dispozicion duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që këshilli bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës së vështirësive financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Cërrik në datën 01.01.2024 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 135,064,467 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2024 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2024 vlera 54,159 mijë lekë nga këto për llogarinë (602-606) vlera 3,794 mijë lekë dhe për llogarinë 230-231 vlera 3,794 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 29,171,309 lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 48,282,600 lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2024 është në vlerën 115,953,175 lekë.

Me shkresën nr.2272/1 prot, datë 30.09.2024 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Cërrik i është drejtuar Këshillit Bashkiak me planin për rehabilitimin dhe daljen nga vështirësia financiare. Referuar analizës së mësipërm nga Bashkia Cërrik është hartuar plani i shlyerjes së detyrimeve për periudhën qershor 2024-qershor 2025.

Plani i shlyerjes së detyrimeve gjenden në tabelën më poshtë:

Detyrimi	Faza e parë qershor 2024 (likuidimet)	Faza e dytë dhjetor 2024 (likuidimet)	Faza e tretë qershor 2025 (likuidimet)	Detyrimi 30.06.2025
135,064,477	12,715,382	37,676,413	32,465,800	87,698,022

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

10. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike rezulton se, janë 4475 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Cërrik (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 2469 prona të 4 Njësive Administrative si *Mollas, Gostimë, Shalës* janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe *Klos* në fazën fillestare. Nga këto prona janë hipotekuar 7 prona dhe janë në proces hipotekimi 38 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 4 NJA *Mollas, Gostimë, Shalës dhe Klos*, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuar, si dhe mos vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr. 669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik nëpërmjet strukturave përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për njësitë administrative; *Mollas, Gostimë, Shalës* dhe *Klos*, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Cërrik nuk ka ndërmarrë asnjë masë për inventarizimin dhe përditësimin e listës përfundimtare të pronave. Gjatë vitit 2024 është riorganizuar struktura e re organizative.

Sektori i Inventarizimit dhe Rregjistrimit nuk është më sektor më vete, kjo shkrirje e këtij sektori ka

sjellë ndërprerjen e plotë të procesit të regjistrimit të pronave publike gjatë vitit 2024. Mungesa e një strukture funksionale ose e një grupi të ngarkuar me përgjegjësinë për menaxhimin e këtij procesi ka krijuar boshllëk institucional në një funksion themelor të bashkisë, me pasoja të drejtpërdrejta në mos formalizimin e pronave shtetërore të kaluara në pronësi ose përdorim. Kjo cenon aftësinë ligjore të bashkisë për të administruar pasurinë publike, e bën të pamundur

mbrojtjen juridike të saj, dhe pengon shfrytëzimin në funksion të interesit të komunitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **në proces zbatimi**.

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 u konstatuan mangësi që lidhen me zhvillimin e tyre, si vijon”.

1. Në të gjitha rastet e testuar, konstatohet mungesa e kërkesës nga sektori përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;

2. Në të gjitha rastet e testuar, për mallra dhe shërbime, në hartimin e fondit limit nuk janë përcaktuar treguesit e çmimeve gjatë testimit të tregut;

3. Në të gjitha rastet e testuar, rezulton se është vendosur fondi limit në urdhrin e prokurimit;

4. Në 8 raste në ftesën për ofertë është vendosur si kriter kërkesa që OE të disponojnë licencë për objektin e prokurimit. Lidhur me këtë kërkesë, rezulton e pa plotë, duke mos përcaktuar se çfarë dokumenti duhet të kërkohet për të përcaktuar llojin e licencës së kërkuar.

- Në 6 raste, ka rezultuar se dokumentacioni i paraqitur nga OE ka mungesë të dokumenteve sipas ftesës për ofertë.

Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim Neni 41, pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7 dhe 8, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 80-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik, Drejtoria Financiare dhe Sektori i Prokurimeve, në zhvillimin e procedurave me blerje të vogla, të marrë masat e mëposhtme:

-Të dokumentohen nevojat dhe kërkesat e institucionit që lidhen me nevojat për mallra dhe shërbime;

-Të dokumentohet përlllogaritja e fondit limit duke vendosur edhe treguesit e çmimeve;

-Të shmangen kriteret e pa plota, duke përcaktuar qartë dokumentin që kërkohet në ftesën për ofertë;

-Në rastet kur Operatorët Ekonomikë, nuk përmbushin kërkesat sipas Ftesës për Ofertë, të bëhet s’kualifikimi i tyre për mos përmbushje të kriterëve;

- Drejtoria e Financës në Bashkinë Cërrik, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

Në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi i procedurave të prokurimeve për vitin 2024 të zhvilluara nga Bashkia Cërrik janë konstatuar të njëjtat problematika si në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim si dhe shpalljen fitues të OE në mos plotësimin e të gjithë kërkesave të parashikuara në DT. Referuar programit të auditimit nr. 408/1prot, datë 08.04.2024 është audituar pika 4 e programit me objekt “Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik” rekomandimi do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

12. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 8 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në e-leje, i kanë miratuar ato në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin.

- Në 6 raste mungon mendimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit që lidhet me miratimin e VNM-ve.

- Në 2 raste preventivat janë të pa plotë duke mos përfshirë zërat e prishjes së objekteve ekzistues.

- Në 1 rast leja e ndërtimit nuk është shoqëruar me lejen e zhvillimit.

- Në 1 rast mungojnë projektet e ngrohje – ftohjes.

- Në 1 rast kemi shkelje të intensitetit duke e tejkalluar atë. Në 1 rast konstatohet policia e sigurimit për projektuesit jashtë afatit të vlefshmërisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa “ç”, neni 15, pika 1/1, germa “iii”, pika 1 germat “g”, “dh”, h”, neni 38 pika 2, Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Shtojca II: pika 10 “Prodhime infrastrukturore” (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin sektorial për projektet ndërtimore, në të kundërt të mos miratohet asnjë leje ndërtimi nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane. Të mos vijohet miratimi për leje ndërtimi për objektet për të cilat është e nevojshme miratimi me VNM-ve, pa bashkëvepruar me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

- Në 2 (dy) raste të lejeve të ndërtimit dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë.

a) Policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale për hartuesit e projektit sizmik është jashtë afatit të mbulimit

b) Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG

-Në 1 (një) rast u konstatua se në një rast, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, siç janë lartësia e lejuar për objektet bujqësore dhe distancat urbane nga kufiri i pronës dhe distancat minimale të lejuar

- Në 2 (dy) raste Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Cërrik, nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, rezultoi se stafi i rekrutuar përfshirë Kryeinspektorin dhe 1 inspektor nuk kanë arsimin e duhur, duke mos dhënë garanci për një kontroll cilësor dhe efektiv të territorit. Është aplikuar vendosja e masës së gjobës për objektet pa leje, por rezultoi se ajo nuk është me përlllogaritje sipas vlerës së punimeve pa leje. Rezultoi se në asnjë rast nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit për ndërtimet pa leje. Rezultoi se janë nxjerrë 4 vendime për prishjen e ndërtimeve pa leje, por nuk është kryer ekzekutimi i këtyre vendimeve. Në një rast për ndërtim çatie nuk është marrë masa për vendimin e prishjes së ndërtimit. Në asnjë rast për vitin 2023, nuk

janë mbajtur aktet e kontrollit për objektet të cilat janë me leje ndërtimit, kjo edhe për shkak se stafi i IMTV nuk ka punonjës me profilin përkatës që lidhet me inxhinierinë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” neni 4, neni 5 germa (a, d, ç), Ligji Nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, neni 52 pika 1 germa “e”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në IMT, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

13.2 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Cërrik të marrë masa si:

- Mbajtjen e akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.
- Aplikimin e masës së gjobës për ndërtimet pa leje sipas vlerës së punimeve.
- Nxjerrjen e vendimeve të pezullimit për çdo rast kur konstatohen punimet pa leje.
- Ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje, dhe në rast se nuk disponon kapacitetet e nevojshme, të kërkojë bashkëpunimin e IKMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi për veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, rezultoi se stafi i rekrutuar, konkretisht Kryeinspektori nuk ka arsimin e duhur, duke mos dhënë garanci për një kontroll cilësor dhe efektiv të territorit. Nga auditimi rezultoi se Sektori i IMT, Bashkia Cërrik për periudhën 01.01.2024 deri me 31.12.2024 nuk ka miratuar planin vjetor të punës. Është aplikuar vendosja e masës së gjobës për objektet pa leje, por masa e tyre nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet ligjore në legjislacionin për mbrojtjen e territorit. Nga verifikimi i kërkesave drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, u konstatua se nuk janë kërkuar kamatëvonesat e krijuara nga mospagesa sipas afateve të caktuara në legjislacionin për kundërvajtjet administrative. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, për rastet e konstatuara me shkelje dhe marrjes së masës së gjobës dhe vendimeve për prishje, nuk është aplikuar masa e pezullimit të punimeve nga ana e IMT Bashkia Cërrik. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacioneve të vëna në dispozicion nga drejtuesit e njësive të menaxhimit të Bashkisë Cërrik, u konstatua se nuk është bërë ekzekutimi i vendimeve për prishjen e objekteve të përcaktuara në Vendim. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është përgatitur dokumentacioni ligjor përkatës për kallëzimet penale lidhur me ndërtimet pa leje të konstatuara nga IMT Bashkia Cërrik. Nga ky inspektorat nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit nga ana e zhvilluesve.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **nuk është zbatuar.**

14. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Cërrik, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 208/10 prot., datë 18.07.2023, (prot Bashkia Cërrik

me shkresën nr. 1427/6, datë 19.07.2023), nga bashkia janë marrë një sërë masash dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.01.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Cërrik është hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së me shkresën nr. 1409/1 prot., datë 16.06.2023 KLSH-së, **brenda 20 ditëve**.

Bazuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **NUK** është dërguar Zbatimi i Plan Veprimit dhe Raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit 6 mujor** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, realizimi është si më poshtë:

- Nga **14 masa organizative**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, **janë pjesërisht zbatuar 3 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa**.

- Nga **7 masa për dëme ekonomike** me vlerë 1,460 mijë lekë, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 1,091 mijë lekë (proces gjyqësor) dhe nuk është zbatuar një masë me vlerë **369 mijë lekë**.

- Nga **9 masa për eliminim e efekteve** negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre, pranuar 100% nga subjekti, nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces 2 masa dhe **nuk është zbatuar një masë**.

- **Për masat disiplinore**. Në plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për punonjësit e Shërbimit Civil dhënien e masave disiplinore “Vërejtje” për 6 (gjashtë) punonjës, e zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.2. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative

1.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK të marrë masat si vijon:

-Të hartojë planin e trajnimeve;

-Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të GMS për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Të miratojë “Planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;

-Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit e Riskut”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në programin e auditimit aktual me nr. 408/1, datë 08.04.2024.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë

korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në programin e auditimit aktual me nr. 408/1, datë 08.04.2024.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Cërrik me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar sipas vendimit nr.190/7, datë 02.07.2024.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në programin e auditimit aktual me nr. 408/1, datë 08.04.2024.

6.2. Rekomandimi: Bashkia Cërrik, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e OE “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar nga Bashkia Cërrik sepse OE “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha ka qënë shoqëri në likuidim dhe është përthithur nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Elbasan gjatë vitit 2024.

12.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet në programin e auditimit aktual me nr. 408/1, datë 08.04.2024.

13.2. Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime në grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e menaxhimit të riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

- Të aplikojë programe elektronike të licensuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të grupit të Punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të raportojë periodikisht lidhur me kryerjen e procesit të monitorimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohe në programin e auditimit aktual me nr. 408/1, datë 08.04.2024.

B. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

8.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamatë vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën 13,680,000 lekë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit.

Gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) për periudhën 01.01.2015-30.11.2024 janë falur me VKM.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj*”, Njësia Administrative Shalës”, Bashkia Cërrrik, me vlerë të kontratës 58,862,977.80 lekë me TVSh, realizuar nga OE “Z” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 139,125 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3519 prot., datë 20.12. 2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrrik dhe OE “Z” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **139,125 lekë pa TVSh** nga OE “Z” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3519 prot., datë 20.12.2022, me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj*”, Njësia Administrative Shalës”, Bashkia Cërrrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi u konstatua se në lidhje më rekomandimin 1.1, Bashkia Cërrrik ka bërë kërkesë-padi Nr 2999 prot date 26.12.2024 në gjykatë për realizimin e arkëtimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës 39,032,808 lekë me TVSh, realizuar nga OE “V” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **157,906 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 354 prot., datë 03.02. 2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **157,906 lekë pa TVSh** nga OE “V” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 354 prot., datë 03.02. 2023, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi u konstatua se në lidhje më rekomandimin 2.1, Bashkia Cërrik ka bërë kërkesë-padi Nr 2991 prot date 26.12.2024 në gjykatë për realizimin e arkëtimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës 57,999,999.60 lekë me TVSh, realizuar nga BOE “M” & “Sh” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **161,280 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 203 prot., datë 19.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **161,280 lekë pa TVSh** nga BOE “M” & “S” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 203 prot., date 19.01.2023, me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi u konstatua se në lidhje më rekomandimin 3.1, Bashkia Cërrik ka bërë kërkesë-padi Nr 2994 prot date 26.12.2024 në gjykatë për realizimin e arkëtimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostimë”, Bashkia Cërrik me vlerë të kontratës 40,401,971.90 lekë me TVSh, realizuar nga OE “A” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **128,842 pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 354 prot., datë 03.02. 2023 të lidhur mes Autoritetit

Kontraktor Bashkia Cërrrik dhe OE "A" ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **128,842 lekë pa TVSh** nga OE "A" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13 prot., date 06.01. 2023, me objekt: "Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostimë", Bashkia Cërrrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi u konstatua se në lidhje më rekomandimin 4.1, Bashkia Cërrrik ka bërë kërkesë-padi Nr 2995 prot date 26.12.2024 në gjykatë për realizimin e arkëtimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas" Bashkia Cërrrik, me vlerë të kontratës 39,032,808 lekë me TVSh, realizuar nga OE "B" ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **114,432 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 341 prot., datë 26.09. 2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrrik dhe OE "B" ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **114,432 lekë pa TVSh** nga OE "B" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 341 prot., date 26.09. 2022, me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas" Bashkia Cërrrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi u konstatua se në lidhje më rekomandimin 4.1, Bashkia Cërrrik ka bërë kërkesë-padi Nr 2992 prot date 26.12.2024 në gjykatë për realizimin e arkëtimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Cërrrik nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore të pa paguara për vlerën **178,598,620 lekë**, nga e cila:

- **vlera 72,954,642 lekë**, e pa kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023, dhe konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë dhe përbëhet nga: - **vlera 2,000,000 lekë**, detyrimi për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve dhe - **vlera 70,954,642 lekë**, detyrimeve për taksës së tokës bujqësore.

- **vlera prej 105,643,978 lekë**, e kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023, dhe njihet nga bashkia si detyrim për arkëtim, nga e cila: - *vlera e detyrimeve tatimore nga abonentët familjar në vlerën 53,752,516 lekë, kjo për 21576 abonentë, nga e cila kontabilizuar vlera 37,524,105 lekë*; - *vlera e detyrimeve tatimore nga subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën 16,921,095 lekë*; - *vlera për TNI nga ndërtimet informale pre 19,650,367 lekë, kjo për 722 perona*; - *vlera nga mos arkëtimi i gjobave nga IKMT prej 15,320,000 lekë.*

Referuar të dhënave nga DTTV Bashkia çërrik për vlerën totale të borxhit tatimore e cila paraqitet në shumën **175,549,380 lekës**, debitorët e taksës së tokës bujqësore zë 44.2% të totalit;

Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun XI “*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit familjarë që kanë ndaj Bashkisë Çërrik konstatohet se deri më datën 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 37,524 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 janë likuiduar detyrime në vlerën 28,604 mijë lekë dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 15,313 mijë lekë. Gjendja debitore më datë 31.12.2024, është në vlerën **43,918 mijë lekë**

Detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Çërrik konstatohet se deri në datë 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 13,871 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 2,162 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 5,360 mijë lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2024, është në vlerën **17,070 mijë lekë** dhe i përket 86 bizneseve.

Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2024, janë në vlerën **60,988 mijë lekë**.

-Detyrime abonentët familjarë në vlerën **43,918 mijë lekë** e cila përbëhet nga 3,820 abonentë familjarë;

-Detyrime nga bizneset në vlerën **17,070 mijë lekë** e cila përbëhet nga 86 subjekte biznesi; Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në **proces zbatimi** .

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejes së ndërtimit të zhvilluesit B. S. dhe R. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit, duhet të jetë 293,029 lekë dhe jo 210,516 lekë, sa është llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Çërrik sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në përlllogaritje e kryer rezulton se është marrë për bazë një preventiv i pa plotë në vlerën 10,525,813, ndërkohë që preventivi i plotë për gjithë objektin është më i lartë dhe konkretisht 14,651,461 lekë, mbi të cilin duhej kryer edhe përlllogaritja e TNI.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej **82,513 lekë**, e pa llogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Çërrik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për njoftim detyrimin ndaj subjektit zhvillues B. S. dhe R.

S., për të bërë të mundur arkëtimin e shumës **82,513 lekë** si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhur të pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Cërrrik.

Brenda datës 30.9.2024

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është konstatuar se; Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave, ka kryer arkëtimin e detyrimit. Ky detyrim është arketuar me mandatin Nr. 292 datë 11.04.2024 .

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar plotësisht** .

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **8** procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Cërrrik për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, me fond limit 271,875 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në 8 procedura nga 8 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 271,875 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në 7 procedura nga 8 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 232,433 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Cërrrik, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT. Kualifikimi i 7 OE pa plotësuar kriteret e vendosura në DST përbën përdorim të fondeve publike pa eficientë në vlerën 232,433 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave” neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2, etj
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Cërrrik) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të

jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

- Në 8 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

- Në 1 rast të blerjes së karburantit nuk është dokumentuar llogaritja e fondit limit, duke mos argumentuar nevojat reale.

- Në 3 raste kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

F. MASA DISIPLINORE

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Çërrrik, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 3 punonjës, si më poshtë:

1. Z. Ç.Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyje-Kullotave dhe Kullimit e Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Zj. M. L. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike. Për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” për:
- Mos kryerje të procedurave për transferimin përfundimtar të pronave për Njësitë Administrative: Mollas, Gostimë, Shalës dhe Klos, duke mos kryer përditësimin e listave paraprake të inventarëve pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe mos hipotekimi i pasurive të paluajtshme të transferuara.

3. Z. K. B., me pozicion Përgjegjës Sektori, për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

G.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “*Masa Disiplinore*” dhe kontratës individuale, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Cërrrik**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse “**Vërejtje**” për 2 punonjës, si më poshtë:

1. Z. F.U., Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në miratimin e lejeve në kundërshtim me legjislacionin sektorial, dhe përlllogaritja e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2. Z. F. Q., Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit, zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe mos ndjekja e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e gjobave; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

G.3. Për të gjithë punonjësit e tjerë të trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është konstatuar se;

Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr 293 dt 26.09.2024 “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në Bashkinë Cërrrik*”, është ngritur Komisioni Disiplinor. Data e zhvillimit të seances dëgjimore 16.10.2024. komisioni Disiplinor nuk ka marre vendim per mase disiplinore.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Bulqizë, të ndërmarre veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin*

Civil”, i ndryshuar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është konstatuar se; Nuk ka pasur masa disiplinore dhe për këtë arsye nuk është njoftuar KMSHC dhe DAP.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

H. PËR MASA ADMINISTRATIVE.

H.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim”, 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 41 – “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, 67- “Klasifikimi i ofertave”, 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit”, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58- “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

a- Anëtarët e Hartimit të specifikimeve teknike dhe Njesisë së Prokurimit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, respektivisht:

1- Procedura me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”. Bashkia Cërrik, me fond limit 49,833 mijë lekë, me fitues BOE “M” Shpk & “Sh” ShPK, viti 2022 me vlerë të ofertës 48,333 mijë lekë;

2- Procedura me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, me fond limit 32,548 mijë lekë, me fitues OE “V” ShPK, viti 2022 me vlerë të ofertës 48,333 mijë lekë;

3- Procedura me objekt: “Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” + punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë”. Bashkia Cërrik, me fond limit 5,260 mijë lekë, me fitues OE “E” ShPK, viti 2022 me vlerë të ofertës 5,250 mijë lekë;

4- Procedura me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime”. Bashkia Cërrik, Viti 2022, me fond limit 33,818 mijë lekë, me fitues OE “A” ShPK, viti 2022 me vlerë të ofertës 33,668 mijë lekë;

5- Procedura me objekt: *“Ndërtim KUZ dhe rikonstruksion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen”*, Bashkia Cërrik, me fond limit 23,038 mijë lekë, me fitues BOE “G” ShPK & “V K” ShPK, viti 2022 me vlerë të ofertës 22,361 mijë lekë;

6- Procedura me objekt: *“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”*. Bashkia Cërrik, Viti 2023, me fond limit 38,309 mijë lekë, me fitues OE “Z” ShPK, me vlerë të ofertës 37,696 mijë lekë;

7- Procedura me objekt: *“Sistemim varrezave të qytetit Cërrik”*. Bashkia Cërrik, Viti 2023, me fond limit 5,995 mijë lekë, me fitues OE “M” ShPK, me vlerë të ofertës 5,693 mijë lekë;

8- Procedura me objekt: *“Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të fëmijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Njësia Administrative Klos”*. Bashkia Cërrik, Viti 2023, me fond limit 83,070 mijë lekë, me fitues BOE “M” ShPK & “Sh” ShPK, me vlerë të ofertës 80,571 mijë lekë,

Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, si dhe nenet 41 –*“Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”*, 78- *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”* të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

b- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimin të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë *“Çmimi më i leverdishëm”*, respektivisht:

1. Procedura me objekt: *“Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”*. Bashkia Cërrik, Viti 2022, me fond limit 49,833 mijë lekë, me fitues BOE “M” ShPK & “Sh” ShPK, me vlerë të ofertës 48,333 mijë lekë;

2. Procedura me objekt: *“Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”*, Bashkia Cërrik, Viti 2022, me fond limit 32,548 mijë lekë, me fitues OE “V” ShPK, me vlerë të ofertës 48,333 mijë lekë;

3. Procedura me objekt: *“Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” + punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë”*. Bashkia Cërrik, Viti 2022, me fond limit 5,260 mijë lekë, me fitues OE “E” ShPK, me vlerë të ofertës 5,250 mijë lekë;

4. Procedura me objekt: *“Ndërtim KUZ dhe rikonstruksion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen”*, Bashkia Cërrik, Viti 2022, me fond limit 23,038 mijë lekë, me fitues BOE “G.T” ShPK & “V.K” ShPK, me vlerë të ofertës 22,361 mijë lekë;

5. Procedura me objekt: *“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”*. Bashkia Cërrik, Viti 2023, me fond limit 38,309 mijë lekë, me fitues OE “Z” ShPK, me vlerë të ofertës 37,696 mijë lekë;

6. Procedura me objekt: *“Sistemim varrezave të qytetit Cërrik”*. Bashkia Cërrik, Viti 2023, me fond limit 5,995 mijë lekë, me fitues OE “M” ShPK, me vlerë të ofertës 5,693 mijë lekë;

7. Procedura me objekt: *“Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të fëmijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Njësia Administrative Klos”*. Bashkia Cërrik, Viti 2023, me fond limit 83,070 mijë lekë, me fitues BOE “M” ShPK & “Sh” ShPK, me vlerë të ofertës 80,571 mijë lekë.

Veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, nenet 3- *“Parimet e përzgjedhjeje”*, 9- *“Anulimi i një procedure”*, 76- *“Kriteret detyruese për skualifikim”*, 92- *“Shqyrtimi i ofertave”*, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, *“Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, 83- “Njoftimi i fituesit”. (Trajtuar në pikën 4 faqe 76-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është konstatuar se; Agjensia e Prokurimit Publik me vendim Nr 19 date 21.03.2025 ka vendosur një gjobe për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe antarët e Njesisë së Prokurimit. Për sa më sipër trajtuar, pas verifikimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është zbatuar.

IV.REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Cërrik nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Cërrik nuk ka miratuar Kodin Etik. Nuk dokumentohet realizimi i takimeve të GMS përgjatë vitit 2024. Nuk është miratuar një regjistër i integruar i riskut për të gjithë institucionin. Nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Cërrik. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme jo në përputhje me: Ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 8, pika d, neni 16 pika 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1, Udhëzimin nr. 16 të MFE, pika 2.2.4, Kreu II kap. 2.2.6., kapitulli 5, Kreu II kap. 2.2.6. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1.1 , faqe 16-21, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik nëpërmjet strukturave drejtuese, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Kodit të Etikës për institucionin, hartimin e një plani trajnimesh për personelin e institucionit, hartimin dhe miratimin e regjistrit të riskut dhe të një strategjie të plotë të riskut, dokumentimin e punës së GMS nëpërmjet mbajtjes së procesverbaleve, si dhe të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit për çdo proces pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Sektorit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Cërrik, u konstatua se në Planin Vjetor të Auditimeve janë planifikuar 7 angazhime auditimi dhe janë realizuar 6 angazhime auditimi. Mos realizimi i planit vjetor nuk është argumentuar në Raportin Vjetor dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

Për vitin 2024, Njësia e Auditit të Brendshëm nuk është e plotësuar, ku gjatë vitit ka pasur në përbërje dy specialistë të Auditit të Brendshëm, në vend të tre punonjësve sipas VKM nr. 83 datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3.

Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit.

Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me: Manualin për Auditimin e Brendshëm “Formatet Standard për Kapitullin IV”, paragrafi 6, Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11 pika ç, neni 13, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. pika 13, Ligji Nr.9154, datë 06.11.2003 neni 22, “Normat Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 19 pika . (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1.2 , faqe 21-23, të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Cërrrik të marrë masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditimit dhe të certifikojë dhe trajnojë audituesit e brendshëm për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të zbatojë Planin Vjetor të auditimeve dhe të argumentojë çdo ndryshim të tij nëse do ketë, si dhe të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Cërrrik së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024, ka devijime me vlerën e planifikuar. Për vitin 2024, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 504,005 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 573,872 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 507,376 mijë lekë ose në masën 88 %.

Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 172,883 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 139,607 mijë lekë ose në masën 80.75%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2024 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 145,819 mijë lekë dhe realizuar 136,526 mijë lekë ose në masën 93 %. Mosrealizimit i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Cërrrik në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, gema “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.1 , faqe 23-35, të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Cërrrik, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi

të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

-Kryetari i Bashkisë nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak “*Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026*” për miratim në kundërshtim me Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore*”.

-Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme është paraqitur në Këshillin Bashkiak dhe është miratuar me VKB nr.29, datë 27.04.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.527/1 prot, datë 03.05.2023. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuara.

-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2024-2026 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.29, datë 27.04.2023 në kundërshtim me afatet e përcaktuara.

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2024-2026 janë miratuar me VKB nr. 56, datë 31.07.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 897/1 prot., datë 07.08.2023 në kundërshtim me afatet e përcaktuara.

- **Faza e dytë e PBA 2024-2026**

Me VKB nr.68, datë 29.09.2023 është miratuar kalendari i konsultimeve publike për buxhetin 2024 dhe PBA 2024-2026. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.1087/1, datë 09.10.2023.

Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore*”. Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore*”, pika 63, 64, 79, 83 dhe 84. Ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.1 , faqe 23-35, të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Çërrrik, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat e nevojshme që të ndjekë të gjithë fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë/privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Çërrrik kryhet në programin Excel. Drejtoria e të Ardhurave Vendore kryen regjistrim manual të të dhënave disponon regjistra fizik por në këto regjistra paraqitet informacion vetëm për pagesat e kryera nuk disponohet informacion për abonentët familjarë debitorë. Gjithashtu për abonentët të cilët janë të përjashtuar nga taksat dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale me nr.90, datë 27.12.2023 “*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Çërrrik për vitin 2024*” nuk është regjistruar statusi i tyre “pensionist”, “ndihmë ekonomike” etj.

Informacioni i azhurnuar për abonentët familjarë gjendet vetëm në regjistrat elektronikë në formatin excel.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 35-45 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masa për hartimin e regjistrat të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë dhe abonentët familjarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” u konstatua se, më datë 31.12.2023, kjo llogari paraqitej në vlerën 3,669,767,389 lekë. Gjatë vitit 2024, llogaria është kredituar me shumën 190,409,070 lekë dhe debituar me shumën 425,157,802 lekë, duke rezultuar në pakësime neto në vlerën 234,748,732 lekë. Nga analiza e kreditimeve/debitimeve dhe çeljes së vitit ushtrimor, llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” duhej të paraqitej në vlerën 3,904,516,121 lekë. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar, kjo llogari është raportuar në vlerën 3,825,555,534 lekë, duke rezultuar e nënvlerësuar me shumën 4,368,811 lekë. Sa më sipër veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 1.1 trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë sistemimet kontabël të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në pasqyrat e konsoliduara në vlerën 41,068,507 lekë.

Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Cërrik gjendja e llogarive të klasës 4 është në vlerën 183,834,540 lekë pasqyruar si më poshtë:

-Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”: 152,189,711 lekë.

-Llogaria 421 “Detyrime ndaj personelit” : 24,957,934 lekë.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” : 1,185,575 lekë.

-Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore” : 4,834,707 lekë.

-Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore” : 666,613 lekë.

Referuar analizës së mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” duhej të paraqitet në pasqyrat e konsoliduara për vlerën 183,834,540 lekë. Kjo llogari është nënvlerësuar për vlerën 142,766,033 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes, raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 59. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Cërrik të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*” dhe 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”, për të mundësuar dhënien e saktë të informacionit kontabël dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në pasqyrat financiare është pasqyruar llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” në vlerën 142,766,033 lekë kjo llogari përdoret vetëm nga degët e thesarit për të evidentuar gjatë vitit detyrimet dhe monitorimin e situatës financiare në fund të vitit fiskal kjo llogari nuk paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar pika 42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të mos kryejë kontabilizimin e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të kontabilizohen në llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin*” me kundëparti llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” për vitin 2024 rezultoi se në këtë llogari janë kontabilizuar 4 projekte me kosto historike totale prej 4,484,659 lekë. Këto projekte përbëjnë pjesë integrale të investimeve publike të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, projektet duhet të kontabilizohen në llogaritë përkatëse të aktiveve në momentin e marrjes në dorëzim të aktivitetit të investuar, pasi ato janë pjesë përbërëse e këtij aktivi. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar klasa 2 aktivitet afatgjatë materiale. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin kontabël të vlerës 4,401,247 lekë në llogaritë përkatëse për aktivitetet e investuara, duke kredituar llogarinë 202 “*Studime dhe Kërkime*” dhe debituar llogarinë 21 “*Aktive Afatgjatë*”

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2024, rezulton se:

- Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është paraqitur në bilanc në vlerën 43,500,252 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2024 dhe është regjistruar në bilanc në vlerën 43,500,252 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik

- Llogaria 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*” është paraqitur në bilanc në vlerën 11,169,913 lekë në fund të vitit 2023. Kjo llogari gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 600,000 lekë projekt i transferuar nga llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*”. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 11,769,913 lekë.

Për këto llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlerat e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar në mënyrë analitike, por mbarten vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite.

- Llogaria 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për vitin 2024 nuk disponon një regjistër të përditësuar në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në*

njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe 27.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë, 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, 211 “*Pyje, Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

Drejtoria e Financës referuar procedurës së inventarizimit të kryejë analizimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” gjatë vitit 2024 u verifikuan shtesa për 2 investime në shumën 39,521,259 lekë.

1- Përmirësim i banesave sociale 11,934,793 lekë

2- Përmirësim i banesave sociale 27,586,466 lekë

Aktivitet e kontabilizuara në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Cërrrik. Këto janë asete në pronësi të komunitetit të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 46-64 të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor të të dhënave për llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*” dhe të marrë masat për sistemimin e vlerës 39,521,259 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Cërrrik në datën 01.01.2024 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 135,064 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2024 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2024 vlera 54,159 mijë lekë nga këto për llogarinë (602-606) vlera 3,794 mijë lekë dhe për llogarinë 230-231 vlera 50,365 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 29,171 mijë lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 48,282 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2024 është në vlerën 115,953 mijë lekë.

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta, Bashkia Cërrrik duhet të rishikoj buxhetin e vitit të ardhshëm duke pakësuar disa nga investimet e parashikuara për mos të patur përkeqësim të situatës së detyrimeve të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” neni 56 “*Vështirësia Financiare*” .

Gjatë vitit 2024 nuk janë realizuar për mungesë fondesh 1 (një) projekt , 2 (dy) mbikqyrje, 1 (një) kolaudim dhe 1 (një) projekt rikonstruksion rrugësh.

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar,

UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 23-35, të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024, Bashkia Cërrik ka shpenzuar vlerën 1,893 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 janë kontabilizuar 3 vendime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna me vlerë 1,592 mijë lekë, të cilat janë likuiduar. Për vendimet gjyqësore gjatë vitit 2024 është kontabilizuar 1 vendim gjyqësor për pension invaliditetit me vlerë detyrimi 301 mijë lekë e cila është likuiduar plotësisht.

Vlera totale 1,893 mijë lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024 nga Bashkia Cërrik, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.1, faqe 23-35 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit familjarë që kanë ndaj Bashkisë Cërrik u konstatua se deri më datën 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 37,524 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 janë likuiduar detyrime në vlerën 28,604 mijë lekë dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 15,313 mijë lekë. Gjendja debitore më datë 31.12.2024, është në vlerën **43,918 mijë lekë**, e cila përbëhet nga 3,820 abonentë familjarë;

Detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Cërrik konstatohet se deri në datë 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 13,871 mijë lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 2,162 mijë lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 5,360 mijë lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2024, është në vlerën **17,070 mijë lekë** dhe i përket 86 bizneseve.

Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2024, janë në vlerën **60,988 mijë lekë**

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 35-45, të Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Cërrik, Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 60,988 mijë lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit lidhur me legalizimet e ndërtimeve pa leje, si dhe listat për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Elbasan, ka përcjellë zyrtarisht listat e qytetarëve të pajisur me leje legalizimi. Deri më datë 31.12.2024, detyrimi i papaguar i taksës së ndikimit në infrastrukturë arrin vlerën 20,682,982 lekë për 497 përfitues. Gjatë vitit 2024, detyrimi i krijuar për këtë taksë është në vlerën 2,304,000 lekë për 47 persona, nga i cili është arkëtuar vetëm shuma 313,000 lekë, duke rezultuar debitorë në vlerën 1,991,000 lekë. Më datë 31.12.2024 gjendja debitorë totale është 20,682,982 lekë për 497 persona, shumë e cila përfaqëson të ardhura të paarkëtuara për Bashkinë Cërrik. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se nga Bashkia Cërrik për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë, si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 35-45 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara me vlerë 20,682,982 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se në territorin e Bashkisë Cërrik për vitin ushtrimor 2024 kanë ushtruar aktivitetin 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, u konstatua se në fund të vitit 2024, gjithsej rezultojnë 11 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, të cilat e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 3 subjekte me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Cërrik të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk

administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa licencë.

Nga auditimi i pagesave për licencat e subjekteve të hidrokarbureve, rezultoi se 6 subjekte kanë kryer total pagesën në vlerën 1,000,000 lekë, ndërsa 5 subjekte kanë kryer pagesa pjesore nga 200,000 lekë çdo vit në kundërshtim me VKM nr. 344 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”

- “G.O.” sh.p.k. Gostim me NIPT L5 me afat licence deri më 16.12.2025 është debitor në shumën 200,000 lekë.

- “G.O.” sh.p.k. Kamuna me NIPT L5. me afat licence deri më 11.12.2025 është debitor në shumën 600,000 lekë.

- “D.O.” sh.p.k me NIPT L42. me afat licence deri më 22.09.2024 është debitor në shumën 600,000 lekë.

- “X.O.” sh.p.k. me NIPT L4 me afat licence deri më 16.09.2024 është debitor në shumën 200,000 lekë.

- “L.O.” sh.p.k me NIPT L5 me afat licence deri më 06.03.2027 është debitor në shumën 400,000 lekë.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 35-45, të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,800,000 lekë për subjektet.

-“G. O.” sh.p.k. Gostim me NIPT L53 detyrimi 200,000 lekë

-“G. O.” sh.p.k. Kamuna me NIPT L53 detyrimi 600,000 lekë

- “D. O.” sh.p.k me NIPT L42 detyrimi 400,000 lekë

- “X. O.” sh.p.k. me NIPT L42 detyrimi 200,000 lekë

- “L. O.” sh.p.k me NIPT L52 detyrimi 400,000 lekë

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Rekomandimi: Bashkia Cërrik, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontrata të qirasë rezultoi se Bashkia Cërrik ka lidhur gjithsej 700 kontrata qiraje, të cilat i përkasin Bashkisë Cërrik dhe Njësi Administrative (ish-

komunat). Njësia Administrative Mollas disponon 62% të totalit të kontratave ose 431 kontrata, këto kontrata janë lidhur përpara vitit 2015 nga ish Komuna Mollas.

Nga këto kontrata 273 janë aktive të cilat ju ngarkohet detyrimi referuar kontratës dhe paguajnë rregullisht. Për 158 kontrata nuk janë ngarkuar detyrimet prej vitit 2017 për shkak sepse është paraqitur kërkesës nga abonentë për zgjidhjen e kontratës, por nuk është konkluduar më tej.

Nga këto 92 kontrata janë me vlerë detyrimi në shumën 14,323,599 lekë, ndërsa 66 kontrata nuk kanë vlerë detyrimi. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 35-45 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, të ngrejë një grup punë për të vlerësuar gjendjen e parcelës dhe kulturën bujqësore të mbjellë dhe më pas të procedohet më prishjen e kontratës për shkak se nga personat qiramarrës është shprehur vullneti me anë të kërkesës më shkrim për prishjen e kontratës. Relacioni i cili do të përgatitet nga grupi i punës të raportohet dhe në Këshillin Bashkiak.

Për 92 kontrata me vlerë detyrimi në shumën 14,323,599 lekë të përgatitet seti i dokumentacionit dhe detyrimi sipas çdo kontrate të kërkohet në rrugë gjyqësore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT